

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 202, Gusht 2020

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

ERNEST KOLIQI

Dukagjinasi (Lotaj, Shalë) që hapi 200 shkolla në Kosovë

2

Ernest Koliqi ka qenë njëri ndër personalitetet e njohura të letërsisë e kulturës shqiptare në përgjithësi. Një kontribut të veçantë i ka dhënë arsimit në Kosovë, në vitin 1941, kur forcat italo-shqiptare kishin depërtuar në vendin tonë dhe kishin dëbuar forcat ushtarake e policore të Mbretërinë famëkeqe jugosllave, e cila gjatë tërë kohës së sundimit nga vitit 1913 e deri në vitin 1941 nuk kishte lejuar asnjë shkollë shqipe por as edhe një libër në gjuhën shqipe. Ata shqiptarë që mësonin ilegalisht gjuhën e tyre ndiqeshin e dënoheshin nga regjimi deri më 20 vjet burg. Dërgimi në Kosovë i më shumë se 200 mësuesve, hapja për herë të parë e qindra shkollave shqipe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, ishte dhurata më e madhe që mund t'i jepej një kombi të ndarë padrejtësisht dhe të persekutuar mizorisht vetëm për shkak të përkatësisë së tij kombëtare e fetare. Pavarësisht se Koliqi i mbeti besnik Italisë, nuk mund të thuhet se ka qenë besnik i fashizmit, me faktin se ai gjatë asaj kohe ka ndihmuar, aq sa ka pasur mundësi edhe intelektualët shqiptarë, të cilët regjimi i trajtonte si armiq. Pas çlirimit nga Italia, Koliqi u anatemua se bashkëpunëtor i regjimit italo-shqiptar dhe vepra e tij nuk u vlerësua. Megjithatë, Koliqi me punën dhe veprën e tij, me kontributin që i ka dhënë letërsisë, kulturës, albanologjisë, sidomos hapjes së shkollave shqipe në Kosovë e më gjerë, është një kontribut madhor, që nuk e zbeh aspak përkatësia e tij partiake në një kohë të caktuar. Koliqi meriton ta ketë një përmendore në qendër të Prizrenit apo të Prishtinës. (A. Q.)



QËNDRESA E DUKAGJINIT, KUNDËR NDËRHJRJES USHTARAKE TË MALIT TË ZI, NË MUAJIN KORRIK TË VITIT 1915

Pak histori

Dukagjini, si e gjithë Shqipëria, e ushquu pavarësinë me barutin e martinave dhe gjakun e djemve të vet. Pavarësia e Shqipërisë erdhi e vonuar dhe gjysmake e ndikuar nga shume faktorë të brendshëm e të jashtëm. Fqinjët nuk u nginë me ato që u dhanë Fuqitë e Mëdha me 1913, por donin prape. Kërkesat e tyre po ndikonin që Pavarësia e Shqipërisë të ishte e brishte edhe për shumë kohë.

Me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, me 28 korrik 1914, serbët e malazezët i drejtuan sytë nga tokat shqiptare, të cilët duke përfituar nga situata, të realizonin qëllimet e tyre shoviniste. Në muajin qershor 1915, ushtritë malazeze, kaluan kufirin në shumë drejtime, veçanërisht në drejtimin Krajë-Tarabosh-Shkodër, me komandant Gjeneral Serdar Vukotich dhe Podgorice-Hot-Shkodër, me komandant ...

3



LAZER STANI PËR DIELLIN: KOLIQI DHE CAMAJ, MAJA TË LETËRSISË SHQIPE

10

Shkrimtari Lazer Stani komenton ekskluzivisht për gazetën Dielli, Organ i Federatës Panshqiptare të Amerikës VATRA, Neë York, debatin mbi figurën e Martin Camajt dhe Ernest Koliqit ku shprehet se dokumentet dhe dosjet e përpiluara nga sigurimi i shtetit, ky aparat monstruoz dhe kriminal, nuk mund të trajtohen si dokumente historike. Sigurimit nuk i ka interesuar kurrë e vërteta, po vetëm goditja, eliminimi, asgjësimi e diskreditimi i atyre që ai i konsideronte si kundërshtarë politikë të regjimit. Me Lazer Stanin bisedoi gazetari i Diellit Sokol PAJA.

LUFTA E HARRUAR E KOPLIKUT, NË 100 VJETORIN E SAJ

Bazuar mbi fakte të vërteta burimore të historiografisë shqiptare, apo relacioneve zyrtare e jo zyrtare si dhe të trashëgimisë gojore, Lufta e Përgjakshme e Koplikut, njihet si qëndresa më heroike e luftës shqiptare, ...

"ORË LETRARE", NË MALËSI TË MADHE

Sa herë që duam të kujtojmë apo të flasim për të shkuarën, si parantezë mendimi, shpesh vendosim togfjalëshin «na ishte dikur», ku jo rrallë na bëjnë që të ndihemi në faj për pamundësinë për ta kthyer kohën pas, që disa gjëra të ndryshe, sidomos ...

14

ERNEST KOLIQI

Dukagjinasi (Lotaj, Shalë) që hapi 200 shkolla në Kosovë



Ernest Koliqi ka qenë njëri ndër personalitetet e njohura të letërsisë e kulturës shqiptare në përgjithësi. Një kontribut të veçantë i ka dhënë arsimimit në Kosovë, në vitin 1941, kur forcat italo-shqiptare kishin depërtuar në vendin tonë dhe kishin dëbuar forcat ushtarake e policore të Mbretërinë famëkeqe jugosllave, e cila gjatë tërë kohës së sundimit nga vitit 1913 e deri në vitin 1941 nuk kishte lejuar asnjë shkollë shqipe por as edhe një libër në gjuhën shqipe. Ata shqiptarë që mësonin ilegalisht gjuhën e tyre ndiqeshin e dënoheshin nga regjimi deri më 20 vjet burg. Dërgimi në Kosovë i më shumë se 200 mësuesve, hapja për herë të parë e qindra shkollave shqipe në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, ishte dhurata më e madhe që mund t'i jepej një kombi të ndarë padrejtësisht dhe të persekutuar mizorisht vetëm për shkak të përkatësisë së tij kombëtare e fetare. Pavarësisht se Koliqi i mbeti besnik Italisë, nuk mund të thuhet se ka qenë besnik i fashizmit, me faktin se ai gjatë asaj kohe ka ndihmuar, aq sa ka pasur mundësi edhe intelektualët shqiptarë, të cilët regjimi i trajtonte si armiq. Pas çlirimit nga Italia, Koliqi u anatemua se bashkëpunëtor i regjimit italo-shqiptar dhe vepra e tij nuk u vlerësua. Megjithatë, Koliqi me punën dhe veprën e tij, me kontributin që i ka dhënë letërsisë, kulturës, albanologjisë, sidomos hapjes së shkollave shqipe në Kosovë e më gjerë, është një kontribut madhor, që nuk e zbeh aspak përkatësia e tij partiake në një kohë të caktuar. Koliqi meriton ta ketë një përmendore në qendër të Prizrenit apo të Prishtinës. (A. Q.)

Ernest Koliqi u lind në Shkodër më 20 maj të vitit 1903. Ishte i biri i Shan Koliqit dhe i Ages së Cuk Simonit, nip Parrucejsh, familje shkodrane fort e kamur. Ndërsa nga babai kishte origjinën prej Lotajve të Shalës së Dukagjinit, të cilët kishin rënë në krahinën e Anamalit.

Pas mësimeve të para në Kolegjin Saverian të Jezuitëve, i ati e dërgoi për të studiuar në Itali më 1918. Së pari në kolegjin jezuit "Cesare Arici" në Breshia e pastaj në Bergamo. Bashkë me nxënësit

tjerë hap gazetën "Noi giovani" ("Ne të rinjtë"), ku boton poezi të e para në italisht. Kthehet në Shqipëri pasi që gjendja futet në hulli pas Kongresit të Lushnjës, nxë shqipen dhe falë njohjes me Luigj Gurakuqin njihet edhe me shumë intelektualë të kohës. Më 1921 mbahet një konkurs për himnin kombëtar, ku Ernesti merr pjesë me një poezi e cila fitoi çmimin e parë të dhënë nga juria e përbërë prej Gjergj Fishtës, Fan Nolit, Mit-hat Frashërit e Luigj Gurakuqit.

Në mars-prill merr pjesë si përfaqësues i shoqërisë kulturore "Rozafa" në një mbledhje me Harapin nga shoqëria "Bogdani" dhe P. A. Harapin në takimin që formoi grupimin "Ora e Maleve" në dorën e Imzot Llazër Mjedës. Pas Revolucionit Demokratik të Qershorit, Luigj Gurakuqi e thërret në Tiranë dhe e emëron sekretar personal. Aderon në shoqërinë "Bashkimi" të themeluar prej patriotit Avni Rustemi. Më pas emërohet sekretar në Ministrinë e Brendshme, ku ministër ishte kolonel Rexhep Shala.

Me Triumfin e Legalitetit shtrëngohet të dalë në mërgim, doli në veri drejt



Mbretërisë SKS, ku studion gjuhën dhe kundron letërsinë serbo-kroate. Qëndron për dy vjet në Tuzla të Bosnjës me shumë nga krerët e maleve. Më 1928 gjendet në Bari të Italisë mes Bahri Omarit, Sotir Pecit, Sheh Karbunarës dhe Kostë Paftalit. Në Zara të Dalmacisë botoi edhe përmbledhjen e parë me novela, në vitin 1929 ku ishte edhe miku i tij në ideale e në punë gjuhe, Mustafa Kruja. Kthehet në atdhe dhe nis punë si mësues në Shkollën Italiane Tregtare në Vlorë dhe mandej në Gjinnazin e Shkodrës (1930-'33) ku mes të tjerëve do t'iu jepte mësim Petro Mar-

kos dhe Luigj Radit. Nis të verojë ndër bjeshkët e Dukagjinit ata vite ku përpos ndodhive shënonte edhe kangët e buta – siç i thonë në Dukagjin këngëve erotike – kujtime të cilat do t'i shkruante mbas '70 me pseudonimin "Hilushi". Ndërkohë miku i tij Mustafa Kruja i kërkon me mbledhje librat e bibliotekës së tij të cilat qenë shpërndarë ndër françeskanë e jezuitë mbas lëshuan Shqipërinë në dhjetorin e 1924.

Më 1933 jep dorëheqjen nga mësimdhënia për të nisur studimet universitare në Padova. Gjatë periudhës 1934-1936 ishte pjesëtar i grupit botues të përkohshmes "Illyria", ku botoi poemthin në prozë "Quattuo". Në po të njëjtën të përkohshme, në vitin 1935 Migjeni botoi vjershën "Të lindet Njeriu" me nxitje të Koliqit.

Më 1936 e emërojnë Lektor të Shqipes në katedrën e Albanologjisë të drejtuar nga gjuhëtari Carlo Tagliavini. Më 1937 doktoron po në Padova me tezën "Epica popolare albanese" ("Epika popullore shqipe") falë mbledhjeve që kishte bërë P. B. Palaj, tezë doktorate e cila u vlerë-

pte zyra e tij. Panë dritën e botimit tekste shkollore shqipe e libra më shumë se ç'qenë botuar prej vitit 1912 e deri atëherë: botimi i historisë së letërsisë në dy vëllime "Shkrimtarët shqiptarë" më, nën kujdesin e Namik Resulit e Karl Gurakuqit; vijoi botimi i përmbledhjeve të folklorit "Visaret e kombit" me v. IV prej H. Reçit, Spiro Çomorës e A. Palucës dhe shumë arsimtarëve të tjerë, duke e çuar deri në XIV vëllime – punim në aq pak kohë dhe me rëndësi për themelin e studimit të folklorit. Tok me Mustafa Krujën dhe Zef Valentinin thirri në Tiranë Kongresin Ndërkombëtar të Studimeve Shqiptare në vitin 1940 prej ku lindi Institutin i Studimeve Shqiptare me qendër në Tiranë, pararendës i Akademisë së Shkencave. Themeloi e drejtoi të përkohshmen "Shkëndija" në korrik të 1940, e cila qe palestër e mendimtarëve dhe shkrimtarëve të kohës. Në shtatorin e vitit 1941 nis mbi 200 arsimtarë normalistë drejt Kosovës. Në një letër dërguar më 16 tetor 1941 nga ministri i arsimit të Qeverisë së atëhershme shqiptare Ernest Koliqi konsullit shqiptar Nikollë Rrota në Vjenë thuhet se ka angazhuar N. Joklin si organizator të bibliotekave të Shqipërisë me një rrogë mujore prej 600 frangash ari. Përpjekje kjo, si shumë të tjera për ta shpëtuar studiuesin e shumë çmuar, që nuk dha rezultat.

Më 1943 vajti në Romë të vazhdonte punën si ordinar në universitet dhe u emërua ambasador në Vatikan, i fundit para regjimit që do të vinte. Nga një telefonatë merr vesh për kapjen e Petro Markos nga ana e gjermanëve, të cilit i shpëton jetën. Më 6 nëntor 1946 krijohet partia Blloku Kombëtar Independent me bërthamën krijuese e drejtuese të përbërë nga vetë Koliqi, dr. Ismail Vërlaci, Gjon Marka Gjoni dhe Ndue Gjon Marku – duke i ndenjtur veprës së Mark Gjon Markut. Në mars të 1947 themelon dhe kujdeset të botojë të përkohshmen "L'Albanie Libre" që ndali më 1959, e më pas "Lajmëtari i të Mërguemit".

Me dekret të Presidentit të Republikës së Italisë, më 2 shtator 1957, për njohje të prestigjit, Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe e Universitetit të Romës, nderohet duke u bërë Institut i Studimeve Shqiptare dhe Koliqi u emëruar presidenti.

Themelon të përkohshmen "Shëjzat" (it. "Le Pleiadi") që e drejtoi për 18 vjet, e përkohshme kryesore letraro-kulturore e asokohe. Vijimësi e traditës publicistike që la n'atdhe me "Shkëndijat", penat e hershme dhe ato të reja gjetën të satin log ku të kultivonin kulturën shqiptare në mërgim të pandotur nga ideologjia me të cilën përlyhej në atdhe. Ndihton talente të shumë fushave të ikur nga ish-Jugosllavia duke iu dhënë hap-

Ministër Arsimit në qeverinë Vërlaci nën pushtimin italian:

Pavarësisht rrethanave, Koliqi shfrytëzoi deri në skaj mundësitë që i je-

..OËNDRESA E DUKAGJINIT, KUNDËR. NDËRHYRJES USHTARAKE TË MALIT TË ZI, NË MUAJIN KORRIK TË VITIT 1915

- NË KUADRIN E 105 VJETORIT -



Pak histori

Dukagjini, si e gjithë Shqipëria, e ushqu pavarësinë me barutin e martinave dhe gjakun e djemve të vet. Pavarësia e Shqipërisë erdhi e vonuar dhe gjysmake e ndikuar nga shume faktorë të brendshëm e të jashtëm. Fqinjët nuk u nginë me ato që u dhanë Fuqitë e Mëdha me 1913, por donin prape. Kërkesat e tyre po ndikonin që Pavarësia e Shqipërisë të ishte e brishte edhe për shumë kohë.

Me shpërthimin e Luftës së Pare

Botërore, me 28 korrik 1914, serbët e malazezët i drejtuan sytë nga tokat shqiptare, të cilët duke përfutur nga situata, të realizonin qëllimet e tyre shoviniste. Në muajin qershor 1915, ushtritë malazeze, kaluan kufirin në shumë drejtime, veçanërisht në drejtimin Krajë-Tarabosh-Shkodër, me komandant Gjeneral Serdar Lanko Vukotich dhe Podgorice-Hot-Shkodër, me komandant gjeneralin Veshovich, nëpër të cilat iu vërsulen Shkodrës për ta pushtuar.

Forcat e krahut të majtë, të drejtimin Podgoricë-Shkodër, i komandonte gjeneral Radomir Veshoviqi, i cili pasi rrethoi Shkodrën në anën veriore të saj, shtabin e vendosi (vendkomandën) në rajonin Ura e Mesit.

Me 27 qershor të këtij viti u "pushtua" Shkodra! Qyteti i Shkodrës, u "pushtua" me forcat e skalionit të Parë të të dy drejtimeve kryesore. I themi, në thonjëza u "pushtua" Shkodra, se në këtë rast, për çudinë e të gjithëve dhe të vete malazezve, nuk u zhvilluan luftime! Ushtria malazeze u prit me banderola dhe nga e gjithë paria

e qytetit ... Për këtë, në gazetën "Besa Shqiptare", nr. 74, date 29 qershor 1915, në mes të tjerave theksohet: "... *Tubat e ushtrive t'prinuna prejë Gjeneralit Veshovich hine n' Shkodër me ndierzii t'paa shoqe. Kërkuej nuk i'utha një fjalë e randë, as nuk pat kush një t' shtyme, as t' shame, as poshtnime ...*".

Megjithatë, malazezët nuk e ndjenin veten të sigurte në qytet pa nënshtruar Malësinë. Për këtë, planifikuan të mbahen në gatishmëri forcat e skalionit të dytë (rezervat) e krahut të majtë (verior) të frontit, të cilat ishin të vendosur: një Brigadë e Këmbësorisë Malore në rajonin Fusha e Postopojës, me komandant gjeneralin Kostandin Nikiçi; një tjetër Brigadë në rajonin Vrakë, me komandant gjeneralin Marijan Pashën; dhe dy brigada në rajonin Shtoj-Golem-Mes, njërën prej të cilave e komandonte gjeneral Mil Spasi.

Djelmnia e Dukagjinit, me Mehmet Shpendin në krye, kish një emër të dëgjuar në atë kohë. Beteja e Qafës së Agrit, në muajin korrik 1910, në të cilën u thye një nga divizionet turke

më me emër, të komanduara nga Turgut Pasha; luftërat e përbashkëta me Dede Gjon Lulin e Bajram Currin në vitin 1910-1912, ishin një kontribut i jashtëzakonshëm në realizimin e Pavarësisë së Shqipërisë. Heroizmi i këtyre djemve ishte ndjere edhe jashtë kufijve, në Mal të Zi, në Serbi e gjetkë. Prandaj "pushtuesit" e Shkodrës e ndjenin rrezikun dhe menduan, se si mund t'i mashtronin malësorët dhe t'u bënin balle atyre. Një nga masat ishte mbledhja e armëve të malësorët. Për këtë, sipas gazetës "Besa Shqiptare", nr. 74, date 29 qershor 2015, është nxjerrë një urdhër për mbledhjen e armëve, nder të tjera urdhërohet: "*Mbledhja e pushtuesit ... Si mas urdhrit t' Qeverisë pushtuesit duhen me u dhanë gjithkush ...*". Ky urdhër i Krajl Nikolles kishte shkuar edhe në Dukagjin. "*Shala e Shoshi, siç thekson gazeta "Besa Shqiptare", nr. 70, date 19 qershor 1915, kan lidhë besën me qindrue e mos me dhanë armët ...*".

Në këtë kohë kishin në dorë udhëheqjen e djelmnisë së Dukagjinit, me "komandantin" e tyre, Mehmet

◀ sirë ndër faqet e revistës, ndër ta piktori L. Delija, shkrimtarët M. Camaj e F. Karakaçi dhe etnologu V. Malaj.

"Shëzjat shërbyen si tribunë dhe dritare informimi mbi aktivitetet shkencore albanologjike në botë. Ato regjistruen në kroniken e tyre edhe ngjarje shoqërore që në të ardhmen do të vlejnin sadopak si dokumentacion historik e kultural për një periudhë rreth njëzet vjeçare". Martin Camaj Më 4 Maj të 1969 i vdes bashkëshortja Vangjelija. Zhdukja e saj i shkaktoi një mungesë të pazëvendësueshme e ndoshta shpejtoi edhe humbjen e tij. 1975 – Vdes në shtëpinë e tij në Romë më 15 Janar 1975 dhe u varros në qytetin e amshuar me datën 18 të atij muaji i nderuar nga i gjithë komuniteti shqiptar në mërgim, por i mohuar nga vendi i tij. Në ceremoninë e asaj dite kishin ardhur personalitete të ndryshëm, kolegë, shqiptarë, arbëreshë, miq të ardhur nga vende të ndryshme.

Vepra:

Siç u përmend, qasjen e parë që pati me letrat e përshfaqja në revistën që hapën gjatë nxënjeve të para në Itali, të cilat i bëri në gjuhë italishte. Mbas fitoi konkursin për himn kombëtar, Koliqi nxitet nga Gurakuqi të shkruaj atë që do të bëhej poemthi i tij i parë dramatik, "Kushtrimi i Skanderbegut" botuar në shtypshkronjën "Nikaj", Tiranë më 1924 – e cila mbarësh-

tohej nga vëllau i Dom N. Nikajt. Gjatë mërgimit të parë ndërsa bluante ndjesitë e përfutur nga kurbeti dhe malli për vatrën familjare dhe klimën morale që e rrethonte shkruan me pseudonimin Borizani në të përkohshmen e Omer Nishanit. Nxjerr përmbledhjen e dymbëdhjetë novelave "Hija e Maleve", botuar në Zara më 1929. Përmbledhja pasqyron suazën mjaftueshëm harmonike të mjedisit me taban patriarkal, mesdhetar e oriental ku kishte kaluar fëmininë – trung ky që përshkohen nga një shije e hollë perëndimzimi. Fryma qytetare gjithnjë në dialog me atë malësore dëshmon tharmin e formësimit të autorit përmes prozës psikologjike të stilizuar me ëndje, e selitur me themelet dokësore të shpirtit shqiptar.

Boton më 1932 vëllimin e parë të antologjisë "Poetët e mëdhenj të Italisë" me parathënie nga Tagliavini. Ky vëllim përfshin vjersha të përkthyer të katër italianëve të tjerë: Parini, Monti, Foskolo, Manxoni. Personalisht çmonte Giosuè Carducci, Giovanni Pascoli, dhe Gabriele D'Annunzio-n. Edhe vëllimi i tretë ishte i përgatitur por nuk u botua. Tregtar flamujsh (1935) dhe Pasqyrat e Narçizit (1936), Koliqi sjell një botë krejt unike shpirtërore shqiptare, ndërsa gjuha e tij dhe stili i japin frymëmarrje të re letrave shqipe.

Bashkëpunoi me revistat "Hylli i Dritës" e françeskanëve, "Leka" e je-

zuitëve, "Përpjekja shqiptare" e Branko Merxhanit, "Minerva", "Besa" etj. Poezitë më të mira të këtij vëllimi janë ato të shkruara në formë të tingëllimit (sonetit).

Nis të botojë nga viti 1954 deri më 1961, studimin krahasues "Dy shkollat letrare shkodrane – e Etënve jezuitë dhe e Etënve françeskanë". Në këtë studim të tij vërehet përpjekja për të hartuar një histori të mirëfilltë të letërsisë shqiptare, jashtë ngjyimeve ideologjike. Në Firenze boton vëllimin "Poesia populare albanese" ("Poesia popullore shqiptare") ku spikat si studiues i merituar i traditave artistike dhe folkloristike të atdheut të tij. 1959 – Boton vëllimin "Kangjelet e Rilindjes" ("I canti della Rinascita") me përkthimin në italisht, kushtuar arbëreshëve të Italisë, ku i nxit ata të ruajnë gjuhën e zakonet e të kenë besim në pavdekësinë e fisit. 1960 – Boton romanin "Shija e bukës së mbrûme" për të cilin Koliqi vetë shprehet: "Ky tregim parashtron edhe përpjetë imtësisht të hulumtojë dramën shpirtërore të një të riut shqiptar flakruar jashta atdheut nga pasojat e së dytës luftë botnore." (Paraqitje në "Shija e bukës së mbrûme", Shkodër, 1996) Boton studimin "Gabriele D'Annunzio e gli Albanesi" ("Gabriel D'Anuncio dhe Shqiptarët"). 1963 – Boton "Antologia della lirica albanese" ("Antologjia e lirikës shqiptare") ku për herë të parë paraqiten në një gjuhë evropiane përkthimet e liri-

kat më të mira të autorëve shqiptarë të vjetër e të rinj ku theksohen autorët kosovarë me qëllim që të njihen më mirë. Riboton "Shtatë Pasqyrat e Narçizit" (që e kishte botuar së pari në fletoren Gazeta Shqiptare të Bari-t më 1936) ku paraqiten shtatë copa proze poetike që përshkruajnë gjendjen shpirtërore të shkrimtarit. 1965 – Del në dritë "Albania", një monografi italisht, botuar në "Enciclopedia dei popoli d'Europa", Milano ku paraqet një pasqyrë të gjërë mbi Shqipërinë si në pikëpamjen gjeografike, ashtu edhe letrare e historike. 1970 – Riboton poemthin "Simfonia e Shqipeve" (që e kishte botuar për herë të parë në fletoren "Gazeta Shqiptare" të Bari-t më 1936), që është si një testament poetik që nënvizon trashëgiminë kombëtare, lashtësinë dhe traditat e popullit. Kjo vepër ka për argument lartësimin e kohës së kaluar të fisit tonë. 1972 – Botohet vëllimi "Saggi di Letteratura Albanese", Firenze. Një përmbledhje e mirë shkrimesh e konferencash përpunuar gjatë disa vjetëve. 1973 – Vazhdon të përkthejë në italisht pjesë nga Lahuta e Malcís, këngët II-III-IV-V (punë kjo e nisur që në vitin 1961 kur përktheu këngën XXVI; më 1971 këngët XII-XIII-XIV dhe XV).

Përgatiti për botim
Lulash Vatnikaj

Shpendin, të cilët i kishin nise te Krajl Nikolla, gjoja do të merrnin urdhrin prej tij, që në zonën e Dukagjinit nuk do të futej ushtria malazeze, takim i cili nuk u realizua kurrë. Duke shfrytëzuar mungesën e udhëheqjes luftarake të dukagjinasve, menduan se do ta kishin më të lehtë nënshkrimin e tyre, dhe do të kishin më të sigurte krahun e jashtëm të forcave që kanë “pushuar” Shkodrën, në anën veriore të saj, nga goditjet e forcave kryengritëse të malësoreve.

Disa zhvillime luftarake

Rreth datës 2 korrik 1915, ndër-mori ekspeditën ushtarake me

isht Gimajt e Nenmavriqi, me në krye Avdi Kolen. Raporti i forcave ishte shumë i madh në favor të malazezeve. Rreth 300 djem dukagjinas në luftë me rreth 1300-1500¹⁾ ushtar malazeze të komanduara nga një gjeneral, por morali dhe vendosmëria, shpirti liri-dashës dhe luftarak i djemve e kthyen raportin e forcave në favor të tyre, që me veprime luftarake të befasishme, me goditje të pandërprera dhe në të gjitha drejtimet e frontit të rrethimit, në natën e datës 4-5 korrikut, forcat malazeze u detyruan të dorëzohen dhe të kapen rob.

Me datën 5 korrik, forcat ushtarake malazeze me në krye gjeneralin, me

të siguroje frontin e jashtëm Verior të forcave kryesore në Shkodër, nga goditjet e befasishme të malësorëve.

Forcat e gjeneral Mil Spasit u thyen në rajonin e Gurit të Kuq²⁾ nga djemtë e Shoshit, të Kirit, të Sumës e të Prekalit, të cilat rreth datës 10 korrik u vendosen në rajonin Boks-Mes, për t'u rikompletuar e venë në gatishtë.

Forcat e gjeneral Marjanit me gjithë rezistencën në rajonin qafa e Mguilles, që ju bën forcat popullore të vendit, u futen në fshatin Gjuraj, ndalen në rajonin Vukaj-Cekaj-Qeresh. Në Qeresh rifillojnë bisedimet me Kole Pepa (Kola ishte i arrestuar, që në

Një kompani e armikut bën përpjekje për të kap qafën e Kujës, me datën 11 korrik, por thyhet nga forcat e Kujës dhe të Shoshit, duke humbur rreth gjysmën e efektivit dhe tërhiqet nëpër Tebreg për t'u bashkuar me forcat kryesore në Nderkiza. Madje, kënga thotë: “.. / ç' bani Shoshi në Kuje t' Planit / ore e Malit me m' ndihmue / kodra e Kujës asht rrethue / tetëqind vete deke e varrue / ...”; dhe pa tjetër që kjo shifër “tetëqind vete vra e varrue”, duhet marrë me rezerva, se rreth 800-1200 ishin gjithë forcat e kësaj Brigade, por tregon se aty është luftuar rrepte.

Forcat ushtarake malazeze, me gjithë përparimin dhe shumicën në



Lapidari i të rënëve në ngjarjen e muajit korrik 1915, 2019, Në vitin 1970, me rastin e 55 vjetorit të gjakut të tyre, Rushi, në Qeresh u ndërtua Lapidari, i cili u rindërtua në muajin korrik 2015, me rastin e 100 vjetorit të kësaj Qëndresë, nga Shoqata “Atdhetare-Dukagjini”



Kryqi i ndërtuar në vitin nga familja Pjeter nga fshati Plan

rrugëkalimin: Postopojë-Rrjoll-qafa e Beshkasit-Plan-Shalë, me detyrë: të çarmatoste banoret e zonës, të nënshtronte nga ana psikologjike dukagjinasit me prezencën ushtarake, dhe po të ngrinin krye t'i goditnin menjëherë dhe fuqishëm.

Në fshatin Gjuraj e Plan, u mbledhën një sasi armësh dhe u vendosen në “dhomeën e katundit” (ishte emri i një dhome e Qelës së kishës në Plan, ku mblidheshin banoret e fshatit e kuendonin)³⁾ Forcat ushtarake u vendosen në rajonin Lugje të Planit.

Gjeneral Niki i-komandanti i Brigadës-priti përfaqësuesit e Shalës, me në krye Lush Prelen, dhe në takimin me ta, ju premton se, nuk do të lëviznin forcat deri në prurjen e urdhrin të ri nga eprori i tij. Por në natën e datës 3-4 korrik nisi forcat në drejtimin Plan-Qafë Boshi-Breglumi. Në mëngjesin e datës 4 korrik forcat u ndalen në rajonin Qyteza e Dakajve. Shala u ngrit në kushtrim, veçanë-

arme pa shula, te Ura e Shalës kaluan në kulmin e dy armeve të vendosura kryq. Një akt kalorësiak, që historia duhet ta kujtojë e të mos e harroje kurrë. Me datën 6 korrik, ushtria malazeze u la e lirë dhe të shoqëruar nga disa djem kaluan kufirin në qafë Pejë.

Ketë fitore populli e përjetoi në këngë: “... Kral Nikolla ka gabue/ Dukagjinitin s'ke më gëzue/ Për pa shku' gjaku si krue/... Le ta dije mire gospodari / Për Shqipninë asht zot shqiptari/ ...”.

Në kuadrin, tashmë edhe të hakmarrjes, komandanti i forcave kryesore, gjeneral Veshoviqi, rreth datës 8 korrik nisi për në Dukagjin dy forca. Një Brigadë me komandant gjeneral Mil Spasin, në drejtimin Mes-Prekal-Shosh, dhe një Brigadë tjetër, me komandant gjeneral Marjan Pashën në drejtimin Vrakë-qafë Beshkas-Plan-Shalë, me detyrë: Me goditje të dyanshme, të futet në Dukagjin, të nënshtrrojë banoret e tij, t'i çarmatos ata dhe

Vukaj), për të ndal luftimet dhe për t'u kthyer mbrapsht forcat malazeze. Kushtet nuk pranohen. Kola godet gjeneralin dhe largohet me shpejtësi, por në pjesën e shpatit verior të malit të Lurzit (Qereshit), vritet.³⁾ Forcat lëvizin në drejtimin Qeresh-Thanë dhe futen në Plan. Shtabi me një batalion vendosen në rajonin Gurët e Mëdhenj (Nderkiza), një pjese e forcave u ndalen në fshatin Gjuraj dhe pjesa tjetër lëvizin për të dale në Kuje. Armiku në të gjitha drejtimet goditet dhe pëson humbje. Forcat e armikut bien moralisht, se grupe djemsh nga Plani e Gjurajt godasin vendqëndrimet e largohen me shpejtësi në çdo kohë, veçanërisht natën. Djemtë e Shalës e të Shoshit me luftime frontale ndaluan përparimin e armikut në drejtimin Nderkiza-qafë Boshi dhe Boks-qafë Kuje. Gjate datës 10, 11, 12 korrik forcat e armikut tentuan disa herë të çanin rrethimin në drejtimin Nderkiza-qafë Boshi, por u thyen me humbje.

forca e mjete, në organizim dhe drejtim, nga goditjet e rezistenca e forcave popullore Plan-Gjuraj, Shalë e Shosh, Mguille e Toplanë, u dëmtuan rendë dhe u detyruan të ndalet dhe të qëndrojnë në rrethim, në rajonin Nderkiza. Kjo forcë ushtarake e rrethuar, nga disa faktorë subjektive, veçanërisht nga mungesa e një komandanti, udhëheqësi apo udhëheqjeje, që do të siguronte unitetin e drejtimin dhe të veprimeve luftarake të djelmnisë, nuk pësoi fatin e atyre forcave të datës 4-5 korrik 1915, në Shalë.

Në këto kushte, Komandanti i forcave të krahut Verior, Gjeneral Veshoviqi, kompletoi menjëherë Brigadën e gjeneral Mil Spasit dhe e urdhëroi të marshohe në drejtimin Mes-qafë Thanë-Plan, me detyrë: Të nxjerre nga rrethimi forcat e rrethura në rajonin Nderkiza të Planit dhe së bashku me to, të nënshtrrojë Dukagjinitin.

Qëndresa popullore rritet. ►

◀ Grupe luftëtarësh u vendosen në qafë Mguullë, në Gropë të Strelit, në Qeresh dhe në qafë Qytezë, në grykë Thanë, e në rajone të tjera. Në përgjithësi, pleq, gra e fëmijë dhe bagëtia ishin larguar nga fshatrat, nga rajonet e mundshme të zhvillimit të veprimeve luftarake, për në Bjeshkë, duke u vendosur në Lug të Shtjerave, në Gropën e Borës, në Bjeshkë të Planit dhe në Paru të Rrjollit.

Në qafë Mguullë, qëndresa ishte e fuqishme. Në pozicione ishin rreth 50 djem nga fshati Gjuraj me përgjegjës Rrok Ndreu, nga fshati Mguullë me përgjegjës Tom Zefi, dhe 9 djem nga Toplana me përgjegjës Mark Sadrinë. Rreth 30 djem të tjerë u vendosen në rajonin Gojë, Grykë Thanë e Kodër Telaj. Grupe të tjerë qëndronin në gatishmëri në Pla të Madh e në Qeresh. Vija Nderkiza-qafë e Boshit-Narca dhe Nderkiza-Gurët e Shalës-Kodër Kuje ishte e pa tundur nga një pjese e luftëtarëve të Planit, të luftëtarëve të Shalës dhe të Shoshit.

Në qafë të Mguullës lufta ndezët e ashpër. Forcat popullore nuk i lëshojnë pozicionet dhe detyrojnë pararojën e armikut të tërhiqet, në vijën Qershiza-Alavana, për të prite forcat kryesore dhe të riorganizojnë sulmin.

Në mëngjesin e datës 13 korrik, pas goditjes me artileri (mortaja të kalibr 81 mm) pozicionet në qafë të Mguullës, lufta bëhet më e ashpër. Armiku nga epërsia në forca e mjete mudi të kapi qafën. Në këto luftime u vranë 8 ushtarë malazeze dhe nga djemtë mbeten në fushën e nderit Mark Sadria i Toplanës; Tom Zefi, Prenush Zefi, Mhill Zefi, Gjon Nika e Ndue Nika nga Mguulla; Mirash Gjoni e Gjelosh Kola nga fshati Gjuraj dhe Nike Çuni nga fshati i Xhanit.

Armiku, për vijimin e veprimeve luftarake, forcat i ndau në dy drejtime: Një pjese të forcave, deri batalion, lëvizën në drejtimin qafë Mguullë-Vukaj-gropa e Strelit-qafë Boshi, me detyrë: Të zhblllokoje forcat e rrethuara në pjesën Perëndimore të Planit; ndërsa pjesa tjetër e forcave, forcat kryesore, të vazhdonin luftimet në drejtimin qafë Mguullë-Qeresh-Plan-qafë Boshi, me detyrë: Të asgjësoje forcat që mund të bënin rezistencë.

Rruga nuk ishte e lirë. Në gropë të Strelit luftonin Mark Preka (Mir-dita, nga Karma), me Kole Lushën e Ndue Prelen. Vendosmëria e tyre ishte heroike. U vranë rreth 14 ushtarë malazeze, por u vra edhe Marku me bashkëluftëtarët e tij, madje trupin e tij e copëtuan me bajonete. Luftime të ashpra u zhvilluan në rajonin Mbigurë nga djemtë Prel Nika, Pal Leka dhe Pjeter Gjeloshi, të cilët dhanë jetën në fushë të nderit, pasi vranë 4 malazeze. Përpjekje të ashpra luftarake janë bëre

në rajonin Suka e Turkut ku mbeten të vrare 3 malazeze. Në darkën e datës 14 korrik forcat e këtij drejtimi munden të dalin në vijën Mbigurë-Nderkiza dhe të zhblllokojnë në pjesën Perëndimore të Planit, forcat e rrethuara.⁽⁵⁾

Qëndresa luftarake ishte e pashembullt edhe në drejtimin tjetër. Trimëri e rrallë. Tre djem të një shtëpie (gjyshi, djali e nipi) të shtëpisë së Vat Markut, në Kodër Telaj, të cilët nga frëngjitë e kullës së tyre, mbajtën të gozhdur mbi një ore forcat e rreth një kompanie, dhe vetëm me mbarimin e fish-ekëve, dy djemtë (djali e nipi) vriten, ndërsa tjetri (gjyshi) digjet në kulle.⁽⁶⁾

Ushtria hyri në fshatin Gjuraj dhe dogji lagjen Vukaj, Telaj, Cekaj e Tefaj. Qëndresa vijonte, por armiku për të thyer ketë qëndresë vuri në përdorim artilerinë mbështetëse, duke goditur në rajonin Qeresh, qafë Qyteze e deri në Pla të Madh.

Armiku përparonte, hyri në Boks, ku i priti me sopat Ndue Ndreu e Pashka Zefi, të cilët pasi goditen për vdekje një malazez, u vranë. Në mëngjesin e datës 15 korrik, këto forca u futën në Plan, por rezistenca vijonte shpi në shpi, ku vriten Kole Luca, Vocërr e Martin Preka. Edhe gratë nuk u ndan nga djemtë. Ato qëndruan heroikisht në mbrojtje të vendit të tyre, të shtëpisë dhe të familjes së tyre. Mbeten në këto luftime Pashke Zefja nga Boksi, Mrike Matja dhe Bjeshkë Thanja nga Plani.

Pavarësisht nga qëndresa e madhe e popullit, epërsia e armikut në forca e në mjete, bëri të mundur të kalohet në masakër, duke djegur, duke vranë e there pa llogari. Vetëm në ketë datë, u vranë 44 vete dhe u dogjën shtëpitë e Planit. Në këtë luftë të pa barabarte, në një qëndresë dhe heroizëm mbare popullore, dhanë jetën 75 luftëtarë të Planit, në moshën më të mirë, 20-40 vjeç, u dogjën shumë shtëpi, shumë stane bagëtish dhe u theren shumë bagëti

Për këtë qëndresë At' Justine Rrota, në librin "Novela, kallëzime, romane e legjenda", shkruante: "... Ndizet m'atëherë një luftim i mnershem, malësoret e Planit bajn namin mbi ushtarët malazeze, marrin flake malet e qafat për rreth Planit, Kodra e Kujës e Gurët e Shalës, bjeshkët e Pla të Madh, maja e Elbumit e qafa e Shtogut, ushtonin majat e luginat e Planit prej krismës së topit e mitralozit". Vijon: "... për tri dite rresht nëpër ato katunde s'u pa tjetër veç tym e flakë, as nuk mbet kund kulle, shtëpi, as stan bagëtish pa u djege ...".

Hakmarrja nuk kishte kufi. Mar-rin Mehmet Shpendin, Çun Niken, Marash Deline e 10 plançuer dhe i nxjerrin për t'i pushkatuar rreth mbrëmjes së kësaj date. Mehmetin e hipin mbi një gurë dhe i thonë: "Eh' Mehmet Shpendi, e shikon, s'ka më Dukagjin? U shtrua Dukagjini edhe Shq-

ipëria, thirri me inat gjenerali ... ". Jo, u përgjigj Mehmet Shpendi! Aty pranë kishte kryet e djaloshit 18 vjeçar-Marash Gjon Ndou prej fshatit Gimaj. Dhimbja ishte e madhe për ketë djalë, por forca kalorësiake e dashuria për dhjetëra të tjerë, ishte shumë më e madhe. Ai përgjigjet: "... nuk zhduket as Shqipëria e as Dukagjini. Mbi ketë gjak që vadite token shqiptare kane me u ngrite kështjella shqiptare, që nuk kane me dite kurrë mortje ... ".⁽⁸⁾ Dhe në momentin e fundit thërret: "... Toke e qiell dorëzane ju paça lanë / Bese armikut mos me i zane / ... ". Me këtë thirrje të fuqishme mbylli sytë për të mos vdekur kurrë, burri fjalë pak e i mençëm, burri i rrepte me armiqte e i dhembshur për njerëzit e shqipes, burri i shpresës së dukagjinaseve. Ai, që shpatet e maleve kreshnike të Dukagjinit çdo dite i bëjnë apel dhe ushtojnë amanetin e tij për sot e përherë.

Forcat malazeze në mëngjesin e datës 16 korrik u nisën në drejtimin Plan-qafë Boshi-Shalë. Urrejtja e tij ishte e pakufishme, që për një kohë të gjate vazhdoj duke vra, duke djege e prere, kryesisht në fshatrat e Shalës, derisa në afërsi të vjeshtës, pas hyrjes se forcave Austriake-Hungareze, u larguan për në Mal të Zi.

Vijimi i qëndresës luftarake në Dukagjin

Me gjithë barbarizmat e masakrat çnjerëzore që bën, malazezet nuk mundën të mposhtin qëndresën heroike të Dukagjinit. Çetat luftarake me trimat e Dukagjinit në krye, si Vaske Kiri i Kirit ... Lulash Preka i Vuksanajve, që nuk e pushuan asnjë ditë luftën kundër malazezve, duke i ndëshkuar rrepte ... derisa i detyruan të largohen nga ky vend ... ", theksohet nga Ndue Cukeli, në librin "Dukagjini në shekuj", faqe 108.

Dukagjini ishte i lakmueshëm. Gjate zhvillimit të ngjarjeve të mëdha të Luftës së Parë Botërore, pas shpartallimit dhe largimit të ushtrisë malazeze, vendin e tyre e zunë forcat ushtarake austriake-hungareze, të cilat organizuan edhe një njësi me emrin "KIRI", që sipas tyre përfaqësonte të tërë Dukagjinin. Ata vendosen posta ushtarake në shumë rajone të Dukagjinit, në Breglumi, Shosh, Xhan e Boks.

Mbas largimit të tyre, në vitin 1919, një repart ushtarak Italian u vendos në krahinën e Shoshit. Banorët e Shoshit i priten "MIRË", me pushkë në dorë, dhe nen udhëheqjen e Mark Milanit, i kërkon garnizonit italian të largohet, por ata nuk pranuan. Atëherë filloi luftimi dhe në pamundësi t'i bëjnë balle, u detyruan të dorëzohen dhe lihen të lire të largohen nga Dukagjini në drejtimin Prekal-Shkodër.

Banorët e Dukagjinit kishin

deklaruar prej kohësh, përpara Konferencës së Paqes në Paris, në korrik 1919, ku përfaqësuesit e të gjitha krahinave, fiseve e fshatrave të rrethit të Shkodrës i dërguan një note proteste Kryesisë së asaj Konference ... për të denoncuar qëllimet e Serbisë, e cila kërkonte aneksimin Shkodrës me gjithë krahinat dhe me ja bashkëngjitë asaj. Këtë proteste e kane nënshkruar edhe 163 përfaqësues të Dukagjinit, nga Shala-38 vete, nga Shoshi-10 vete, nga Kiri-17 vete, nga Xhani-22 vete, nga Toplana-5 vete, nga Dushmani-8 vete, nga Plani-22 vete, nga Shllaku-13 vete, e nga Temali-7 vete (Shqipëria para Konferencës së Paqes 1919, Shkodër 1920, faqe 42).

Në vitin 1920, forcat vullnetare të Dukagjinit, morën pjesë me armë në dore në luftën e Koplikut, duke luftuar me trimëri për mbrojtjen e tokave Shqiptare nga shovinistët serbo-malazeze. Në këto luftime shquhen për pjesëmarrje e trimëri djelmnia e Shllakut dhe e Dushmanit (D. SH, viti 1996, faqe 111).

Një kronike e kohës, e muajit tetor 1921, shënonte: "... Korrespondenti i ynë në Shalë, na lajmëron se, në orën 1-të natës u dha kushtrimi me dale në qafë Peje, se armiku kishte zane tokën tonë e donte me mësyje. Shala, si e ka zakon gjithmonë tue bërtite e tuj u hallakate si luaj, turret kah qafa e Pejës, ku krisi pushka, por nuk zgjati shume, sepse armiku u largue dhe shaljanet u kthyen në shtëpitë e tyre, tuj kendue e tuj qite pushke prej gëzimit ... "(Dukagjini, botim i shoqatës së mësuesve, Shkodër 1968, faqe 22).

Disa përfundim:

Së pari, Qëndresa e dukagjinaseve nuk u kthye në fitore të përgjithshme, sepse në këto momente nuk mundi të sigurojë një udhëheqje ushtarake popullore, unike, e cila çoi në mos koordinimin dhe unitetin e veprimeve luftarake. Në qoftë se forcat popullore të fshatrave të Shalës e të Shoshit nuk do të shkonin në festë, në festën e Shqurkut të Shoshit, duke braktisur frontin, me datën 13-14-15 korrik, jo vetëm forcat e rrethuara që do të kapeshin rob, por edhe ato të freskëtat do të ishin thyer me turp, më keq se ato turke në korrik 1910 në qafë të Agrit, ose do të ishin kap rob më keq se ato në Nenmavriq, në ditët e para të korrikut 1915. Por, siç thekson At' Justin Rrota, në librin "Rreth Votres", botim i II, viti 2005, në faqe 32: "... Malsorët mbanin të gjitha dervendet, anmiku nuk kish kah me luejt. Veç si ndoll në një çete luftarësh pa dishipline, malsorët për do arsye fare të kota lan pritat e borren luftën. Toplana prejse kishte pase një të vram, për me e përcjell e me i ba gjamen tu shpia, lshoj ▶

◀ *qafën e Mgulles ku kishte ken qendru e dredhoj perpiet, e të vramin mbi vigj, Shoshi e Shalla, prejse ne nesre ishte nata e Shqurkut (13 korrik), feste me miq, lan aty disa prita dhe u derdhen ka shpia për me pre berrin ...". Mos qoftë e thënë, të jetë e vërtetë kjo e shkruar se, Bajraktari i Shalës, apo Krye-pari, le ti thonë si të donë; Bajraktari i Shoshit, apo Krye-pari, le ti thonë si të donë, janë përgjegjësit kryesor i asaj masakre të bërë, në veçanti në këtë hapësirë, në hapësirën Plan e Gjuraj dhe pushtimit të Dukagjini. Janë përgjegjësit kryesor të vrasjes e të masakrimin të 75 burrave e tri grave; janë përgjegjësit kryesor të vrasjes së Mehmet Shpendit vete të 13-tin në Nderkiza të Planit.*

Pse, theksoj në mënyrë të veçante vrasjen e Mehmet Shpendit, se atë nuk e donte paria e Dukagjinit, në veçanti ajo e Shalës. Për të argumentuar këtë theksim të timin, po citoj nga libri "Pasqyra-Ditëve Përgjakshme", libri i parë, botim i vitit 1912, në faqen 41-42, me autor Risto Ll. Siliqi, shkruhet: "... Por sa me akcije reformatore e me ndihma Vase e Pretkeve Hoxhillarë e Priftnive Tyrqit e rijë mriten ti çarmatosin Shqypetart ne Shkoder e rrethit saje, sikurse kryetari Shals Mehmed Shpendi me 10 shpija pelqimtarë të vetë, armet nuk ndegiojti ti japin kur gni menyre, ky, me gni çetë te voghel, nisi të sterkeqin vd haznit e vetë, sidomos pariën e Shales, me menyre pse mei dhan armet, e te jesin si ghratë. Per ket shkake Bajraktari i Shales, Prel Marku u ndis e ra ne Shkoder ku ju hankuë Valis Bedri Beghut, no ti marin armet dhe cubave Mehmed Shpendit, no tja u japim lle ketyne! Bedri Pasha kur vesht e mori, pa vonuë derghoj 400 nizame, nen komande te Ali Beghut e Mustaf' Efendisë, ju dha me vedi dhe 4 topa e 2 mitroleuza, qi të ndjekin Kryekomitin Mehmed Shpendin me 30 fatosha. - Mehmed Shpendin si e lajmunë se ashtë ndisë kundra tii ushtria e Mbretit, u nghreh' e doli si me djelmë pushket si me ghra e fëmi në maje të bjeshkes Thethit Shals, në të cidhen dhe muajin e Ghushtit bora e ftohtë gindet gith' herë!.....

E citova këtë pjesë, për të argumentuar mendimin tim, se ballafaqimi me këtë të shkruar nga Risto Ll. Siliqi dhe At' Justin Rrota nuk kanë shumë nevojë për komente të tjera. Një argument më shumë, për të vërtetuar mendimin tim, është dhe mos pjesëmarrja e asnjë pinjollit të kësaj parie në përrurimin e monumentit të atdhetarit Mehmet Shpendi, me 16 korrik 2015, të vendosur në hapësirën e zonës industriale të qytetit Shkodrës, si dhe dekorimin e tij, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani, me urdhrin e lartë "Nderi i Kombit."

Prandaj, i bëj thirrje inteligjencës dukagjinase, të qëndrohet larg mendi-

meve primitive e raciste, dhe mendoj se, nuk duhet të kruhemi nder-veti shumë!?

Së dyti, Në këtë qëndresë heroike dhe një nder të veçantat për nga koha e hapësira e saj, humbjet në forca dhe dëmet materiale, paguan të gjithë dukagjinast, të gjithë morën pjesë në fitoren, në humbjen dhe në dëmet. Më shumë sakrificë, humbje e dëme u bënë në banoret e fshatit Plan dhe Gjuraj, sepse aty u bë dhe qëndresa më e madhe, më e ashpër dhe u shtri në një kohë prej rreth 13 ditë.

Kjo Qëndresa, Qëndresa e Dukagjinit, për herë të parë, e veçanërisht të katundit Plan e Gjuraj, kundër ushtrisë malazeze, u përkujtua me 15 korrik të vitit 1940, me rastin e 25 vjetorit të saj. Organizatorët e saj ishin: Pader Deda, prej Bërdice, frati i kishës së Planit, me Prel Ndou, Kol Prela, Kol Marku dhe Pjetrush Kola (i pari i djemnisë së Planit) në Prendreaj; Nik Ndoka e Kol Marashi në Thane; Tom Kola në Kuje; Pjeter Mirashi, Pjeter Ndoka dhe Kol Toma në Gjuraj; Pjeter Ndou e Gjesh Kola Dusha në Boks. Këta, përgatiten një kryq si objekt nderimi për gjakun e të rënëve, me gjatësi 3 metra dhe gjerësi 1.74 metra. Kryqi u punua nga Gjek Tusha i Thanit, shkrimet e emrave u përgatiten nga Ndue Çuni i Prendreajve dhe i gdhendi me daltë mjeshtri i punimeve të drunit, Ndue Vata i Boksit.

Në përrurimin e kryqit dhe në përkujtimin e qëndresës morën pjesë, përveç banorëve të Planit e të Gjurajve, edhe: Famullitarët e famullive të Ipeshkëvisë së Pultit, me në krye Ipeshkvin e Tij; frati i kishës së Thethit, Abatit, Shoshit, Kirit, Xhanit dhe frati i Rajës Mërturit, Binak Lulashi; përfaqësuesit e krahinave të Dukagjinit-Kole Ndou i Pecajve, me Lek Currin e Thethit e Mark Sadikun, i pari i djemnisë së Shalës; Lulash Gjeshi i Ndreajve, me Binak Pjetra i Pepaj, i pari i djemnisë së Shoshit; Voc Deda i Kirit, me Zef Marashin, i pari i djemnisë së Kirit; Dede Nika i Xhanit, me Vat Daken, i pari i djemnisë së Xhanit; Lek Ndou i Pogut, me Mirash Ndou, i pari i djemnisë së Pogut.

Megjithëse këta burra të kohës, përfaqësues të gjithë krahinave e fshatrave të Dukagjinit, duke përruruar Kryqin e vendosur në qafë të Qereshit, marrjen pjesë në meshën që u dha për shpirtrat e tyre, në kishë të Planit dhe në drekën e shtruar nga plançuerët, kanë vendosur, që gjaku i të rënëve në luftë, me ushtrinë malazeze, në muajin korrik 1915, të PËRKUJTOHET NË KETË VEND, NË VENDIN E QUAJTUR QERESHI. Por, çudia e madhe, që pas çlirimit të vendit, janë bërë dhe vijnë të bëhen përpjekje që kjo ngjarje të përkujtohet në qafë të Boshit.

Me rastin e nxjerrjes së jashtë ligjit të besimeve fetare, dhe heqjen e gjithë simboleve të tyre, në muajin shkurt të vitit 1967, në vitin 1970, në shenjë respekti e përkujtimi të kësaj Qëndresë e gjakut të të rënëve, në qafë të Qereshit, në vendin ku ishte Kryqi, u ndërta Lapidari, dhe me 15 korrik të atij viti, u vendos zyrtarisht data e përkujtimit të tyre.

Në këtë lapidar janë shkruar:

Shala:

Mehmet Shpendi, Çun Nika e Marash Delia.

Thani:

Kole Ndoja, Ndue Prela, Ndok Prela, Col Deda, Nike Gjoni, Vocer Preka, Deli Preka, Preke Leka, Nik Marku, Zef Preka, Kole Ndue Leka, Nok Mirashi, Luc Mirashi, Gjon Noka, MaÇ Noka, Kol Luca, Bjeshke Dedja, Ded Pjetra, Pjeter Lula e Mark Prela.

Prendreaj

Prel Kola, Gjon Lula, Prek Gjeshi, Stak Mirashi, Pal Nika, Prek Noka, Gjesh Noka, Marash Noka, Gjesh Ujka, Nue Nika, Tom Preka, Ded Preka, Prenash Preka, Prel Doda, Kol Gjoni, Prek Leka, Pjeter Lota, Marash Pali, Sokol Nika, Marash Nika, Çun Marashi, Mrike Matia, Col Marashi, Nik Leka, Ndok Shytani, Mirash Nreu, Gjon Nreu, Mark Lula e Nik Marashi.

Gjuraj:

Mirash Gjoni, Gjesh Kola, Kole Leka, Kole Pepa, Gjergj Pepa, Pal Nou, Gjon Nou, Gac Toma, Vat Marku, Kokërr Nika e Martin Ndoka.

Boksi:

Pale Leka, Pjeter Gjeshi, Nue Nreu, Pashke Zefja, Ndoc Prela, Prele Nika, Kole Pali, Lul Pali, Kol Dusha e Zef Marku.

Megulle:

Tome Zefi, Prendash Zefi, Mhill Zefi, Gjon Nika e Ndok Vata.

Mirdita:

Mark Preka

Toplana:

Mark Sadria

Xhani:

Nike Çuni

Së treti: Në Qëndresën Luftarake të Dukagjinit kanë dhënë jetën 106 dukagjinast, 81 prej tyre në Plan-Gjuraj dhe 25 të tjerë nga fshatrat e krahinës së Shalës, kryesisht fshati Gimaj e Nenmavriq.

Duka bërë një analizë të thellë, të gjere dhe pa paragjykime, mendoj, se Qëndresa Luftarake kundër forcave ushtarake të Malit të Zi, në muajin korrik 1915, gjaku i të rënëve, të përkujtohet në Qeresh, për gjithë Dukagjinin.

Pra, të ndërtohet një lapidar tjetër dhe në te të shkruhen

edhe 25 të rënët e tjerë:

Gimaj: Lulash Tahir Nika, Shpend Deli Kola, Nike Çun Sokoli, Sokol Lulash Preka, Çel Pal Gjoka, Lulash Tahir Nika, Prele Lulash Prela, Kole Shpend Delia, Mark Vuksan Prela, Buc Vat Leka, Nik Mhill Dema, Pjeter Lulash Ndrethi e Marash Ndue Delija.

Nemavriq: Deli Kole Kola, Deli Zhul Delia, Kole Ndue Nika, Çoban Lul Vuksani, Ali Leke Vuksani e Shpend Deli Kola,

Lotaj: Lulash Sokol Vata e Kole Miter Nika.

Vuksanaj: Preke Stak Marku e Hajdar Ujk Luka,

Abat: Vat Gjesh Ndoka,

Toplane: Man Ymer Gjeshi.

Besoj, se ky propozim im, pa paragjykime dhe tejet humanitare, do të gjeje mbështetjen e nevojshme popullore të miratohet dhe me rastin e 107 vjetorit të kësaj Qëndresë të arrihet për tu përkujtuar në vendin e quajtur Qeresh të fshatit Gjuraj.

Ndue Sanaj,

Shkodër, me 25 gusht 2020

Referenca:

1) Libri "Dukagjini në shekuj", me autor Ndue Cukeli, faqe 104; Libri "Dukagjini ynë", me autor Prele Milani e Lazer Kodra, faqe 126,

2) Libri "Dukagjini në shekuj", me autor Ndue Cukeli, faqe 106; Libri "Dukagjini i ynë", me autor Prele Milani e Lazer Kodra, faqe 132,

3) Sipas Gjon Prekës në Plan, në vitin 1970 dhe Mhill Sukaj, në muajin nëntor 2012; Sipas Prek Sokolit në Kuje, në muajin tetor të vitit 1988; Sipas Nike Peshkut, në Boks, në muajin tetor të vitit 1988,

4) Libri "Dukagjini ne shekuj", me autor Ndue Cukeli, faqe 117,

5) Sipas Prek Sokolit, në muajin tetor të vitit 1988,

6) Monografia "Mehmet Shpendi", me autor Pal Doçi, faqe 102,

7) Në arkivin e rrethit Shkodër, me nr. 151/ 1, date 17. 09. 2005

LUMTURIA ËSHTË MES NJERËZVE

Lumturia, thonë se gjendet në një tjetër botë Por njeriu lumturinë e kërkon ta ketë në tokë Ta shohë me sy, siç sheh të vërtetën Ta prekë me dorë, e ta shijoj gjithë jetën . . .

Natyra, shumë të mira na i ka dhuruar, Që ne t'i kemi për t'u lumturuar Ato i kemi mes nesh, nëse dimë t'i kërkojmë E së bashku si njerëz të mirë t'i gëzojmë!

Ndue Mici
26 gusht 2020

KOLË PROGNI

MIKU I PËRHERSHËM I ALPEVE SHQIPTARE

- PO E RISJELL KËTË SHKRIM TË CILIN E KAM BOTUAR VITE ME PARË PËR PROFESOR KOLË PROGNI, ME PAK NDRYSHIME E NJË SHITESË NË FUND, SI HOMAZH PËR NDARJEN E TIJ NGA JETA -

Një buzëmbremje së bashku me time shoqe, Gjysten, shkojmë gjithë qejf për një vizitë në shtëpinë e profesorit të palodhur, Kolë Progni. Për punën e bërë, për përkushtimin dhe vjetërsinë e tij, me të drejtë e thërrasin të gjithë Profesor Kola.

Na presin me shumë mirësi së bashku me bashkëshorten e tij, Marien. Një shtëpi, disi në një qoshe, por me shumë rregullsi. Çdo gjë në vendin e vet, çdo gjë me shije. Mbi të gjitha është mikpritja tradicionale e ruajtur me fanatizëm nga kjo familje, balli i qeshur e shikimi drejt në sy.

Pasi pimë e hëngrëm sa kishim dëshirë, Profesor Kola në fton në kabinetin e tij të punës. Ajo ishte një studio e vërtetë, me murin e mbuluar nga librat, tavolina me mjete bashkëkohore të punës, ngrohje normale, skeda, negativ fotografishë, foto bardh e zi dhe me ngjyra të madhësive të ndryshme, CD me plot etiketa të sistemuara. Çfardo që të kërkosh për punën e tij e gjenë në moment, kaq rregull ka në këtë studio.

Profesor Kola nuk pushon duke lexuar, duke shkruar, skeduar, studiuar, me datë e me orë, me përsona kontakti e emra vendesh.

Pasioni i Tij janë Alpet Shqiptare. Ngado, në shtëpinë e tij shikon foto të zmadhuara me pamje nga Alpet, në disa prej peisazheve duken imazhe të fytyrës së njeriut, kafshësh, të cilat janë pasqyruar në momentin e fotografimit. Ky njeri nuk lodhet duke kërkuar momentin për fotografim, deri sa të plotësohen dëshirat e tij në mënyrë më të mirë të mundshme.

Për të na relaksuar, Maria në sjell kafe. Megjithatë e pashë kur hyri në kabinet, kur unë u kujtova për ta pirë ajo ishte ftohur fare, nga që isha përhumbur në fotot, skedat, hartat, projektet, librat, shënimet e bisedat që nuk kishin të sosur me Profesor Kolën.

Kur po ndaheshim, Profesor Kola më propozoj që të shkonim së bashku në një nga shpellat më të bukura të vendit tonë, në Shpellën e Jubanit. Unë pranova menjëherë.

Në një prej ditëve të këtij dimri, gjitha lagështi dhe me erë të ftohtë, me shumë dëshirë udhëtuam së bashku për në këtë shpellë. Ai e kishte vizituar edhe herë të tjera. Me ne ardhën edhe tre nxënës të shkollës së Jubanit, Alberti, Aureli dhe Refaeli. Ata ishin nxënës të mirë, të kulturuar dhe shumë dashamirës, pavarësisht se takoheshim për herë të parë. Ata kishin për të hyrë në shpellë. Rruga ishte shumë e përpjetë dhe e mbuluar plot me ferra e shkurre të tjera, por nuk ndjemë lodhje, pasi kishim shumë dëshirë për ta vizituar këtë shpellë e cila është një perlë e natyrës shqiptare, por e lënë në harresë.

Kush është Kolë Progni?

Në një shkrim gazetaresk është shumë e vështirë që të jepet i plotë portreti i tij. Gjithsesi do të përpiqemi që lexuesit ti krijohet mundësia për të marrë sado pak njohuri për këtë njeri që të lodhë me heshtjen e tij të zhurmshme.

Kolë Prelë Progni u lind në Salcë të Nikaj Mërturit në vitin 1944, në një familje malësore të varfër por me dëshirën për më mirë. Hyri në rrugën e shkollimit e ju përkushtua mësuesisë me dëshirën që varfëria, mjerimi dhe errësira e një populli

gjeografisë për shkollat e mesme. Më pas për 36 vjet punon në dymbëdhjet shkolla të ndryshme të rretheve Tropojë dhe Shkodër.

Me mbarimin e shkollës së lartë me rezultate shumë të mira, katedra e gjeografisë mendon që ta mbaj aty si pedagog i kësaj lënde, por nuk qe e thënë sepse një “njollë” në biografinë e tij bën që të mos mundësojë qëndrimin e tij në Universitet me gjithë përkushtimin dhe

qenë gjatë gjithë jetës së tij.

Ai merr nga rektorati i Universitetit të Tiranës vetëm një autorizim dhe një aparat fotografik. Kjo ishte e vetmja ndihmë që i u dha e më këto u qepet Alpeve Shqiptare cep në cep. Nuk la mal as luginë, kodër apo pyll, kreshtë apo shpellë, burim apo mriç pa i parë, pa i prekur me dorë e pa i shkelur me këmbë, duke bërë mbi 6500 km rrugë kryq e tërthorë këtyre maleve, por edhe jetën e malësorëve të tyre, gjenezën, etj, etj. Me aparatin në dorë, me fletore e laps në çantë, fotorafoi dhe shënoj gjithçka që i doli përpara, me durim dhe këmbëngulje.

Në fototekën e tij ka mbi 10000 negativ fotosh, mbi 6000 prej tyre më ngjyra janë të skeduar në kompjuter dhe CD.

Profesor Kola nuk i grumbulloi, që ti mbydhë në sirtarin e vet, ti lejë të vdekurra, të harruara. Ai nga koha në kohë ka publikuar në revista e gazeta, në radio e televizor, shumë herë. Ka shkruar mbi 200 artikuj publicistik rreth aspekteve të ndryshme gjeografike, për traditën e popullsisë të këtyre zonave, por edhe shumë trajtime shkencore. Kolë Progni e gjejmë edhe si përgatitës dhe zbatues të projekteve të ndryshme, veçanërisht për Alpet Shqiptare, apo edhe që presin të zbatohen. Fotot e Profesor Kolës i gjejmë në shumë botime, guida turistike, etj. Zëri i tij është dëgjuar shpesh herë në Radio Tirana, Radio Shkodra, e Tv të ndryshme. Ai ka botuar monografinë “Malësia e Kelmendit” që pati shumë sukses. Ka një grumbull materiale që presin të shohin dritën e botimit.

Për punën e tij të përkushtuar është dekoruar me “Medaljen e Punës” dhe ate “Naim Frashëri”.

Profesor Kolën e gjejmë të publikuar edhe në faqet e shtypit, disa prej të cilave janë: “Studiuesi i Shpellave” në gazetën “Zëri i Rinisë” në vitin 1973, “Ç’ke shkruar për zonen tënde” në “Zëri i Popullit” në vitin 1983, “Me pasion pas shkencës së gjeografisë” në gazetën “Mësuesi” në vitin 1980, “studiuesi i Alpeve” në gazetën “Albania” në vitin 1995, “Ky Kelmend shkëmb e gurë, lidh si shqipja me flamur” në gazetën “Ilyria” që botohet në SHBA në vitin 2001, “Alpet i pushtoj Universiteti i pambrtur” gazeta 55, 2003, etj.

Profesor Kola është nismëtar i krijimit të shoqatës shkencore-didaktike të gjeografëve të Shkodrës dhe krytar i saj.

Objektivi i këtij studiuesi të pasionuar është që të botojnë materialet që pothuaj i ka gati si: “Album gjeografiko-Turistik për Alpet, “Bjeshkët e Namuna”, “Shpellat e Alpeve”, “Monumentet e Natyrës në Alpe”, “Guitë-Alpet e Shqipërisë”, etj.



të tërë do të merrte fund vetëm nga pasioni i dijes dhe kulturës, që do të vinte nga dritëza e të nxënës. Jeta dhe vitet e punës e pjekin si mësues e studiues pasionant. Veçanërisht e tërhoqën Alpet Shqiptare me bukuritë dhe rezervat e shumta, të pashtershme dhe të shumëllojshme që bartin në gjirin e tyre.

Profesor Kolë Progni, në vitin 1969 përfundon Universitetin e Tiranës dhe mbron diplomën me temën “Vështrim fiziko-gjeografik mbi Alpet Lindore”, e cila mori vlerësimin më të mirë, duke u diplomuar, kështu, mësues i historisë dhe

përvetësimin e lartë shkencor të lëndës së gjeografisë.

Me gjithë shtyrjen që i bënë, pa asnjë të drejtë që mesa duket ndikoj shumë xhelozia, por u shfrytëzua biografia, Profesor Kola nuk e dha veten. Përsëri përpiqet për të marrë gradën shkencore dhe për këtë likujdoi tre provimet pasuniversitare me cilësi të lartë, por edhe këtu përsëri nuk e bë e mundur mbrojtja e desertacionit për gradën shkencore, sepse e ndiqte ajo “njolla” e përzier me xhelozinë.

Përsëri nuk dorzohet. Kërkimi shkencor dhe veprimtaria botuese e tij kanë



LAMTUMIRË MIKU I SHITRENJTË, KOLEGU, PILOTI DHE STUDJUES NDOC SELIMI

Të nderuar miq të gazetës "DUKAGJINI"!

Nëpërmjet kësaj gazete, japim një lajm të trishtueshëm mortor dhe aspak të zakonshëm të vdekjes për shkak të pandemisë të kolegut tonë, të pilotit, të mikut tonë, të studiuesit dhe autorit hulumtimeve, studimeve dhe të shumë shkrimeve, që një pjese e tyre janë botuar edhe në gazetën tonë "Dukagjini", z. Ndoc Selimi.

Ditën e premte me datë 21. 08. 2020 unda nga jeta në moshën 72 vjeçare mendimtar, studiuesi dhe miku i të gjithë njerëzve, me të cilët pati kontakte z. Ndoc Selimi.

Ndoc Selimi lindi me 24 shkurt 1948 në Koman. Vitet e fëmijërisë i kaloi pranë familjes së tij në vendlindje. Në vitin 1967 mbaroi shkollën pedagogjike në Shkodër, më pas punoi dy vjet në detyrën fisnike të mësuesit, në zonat e thella malore të Kelmendit e jo vetëm.

Në vitin 1971 përfundoi Akademinë Ushtarake të Aviacionit dhe diplomohet

pilot për helikopter, ku punon në këtë profesion për 26 vite.

Në vitin 1992 gradohet nënkolonel dhe kryen funksionin e zëvendës komandantit për fluturim dhe me vonë të shefit të shtabit në Regjimentin e Helikopterëve luftarak në Tiranë.

Në vitin 1997 si pasojë e valës së ashpër politike që përjetoi vendi ynë detyrohet të largohet drejt Italisë. Si njeri i formuar dhe me një potencial të lartë human punësohet në një qendër shumë të rëndësishme sociale, pranë shtëpisë Fëmija dhe Nëna "Farsi Prossimo ONLUC", Milano deri në daljen e tij në pension.

Ndoc Selimi ka studiuar autodidakt letërsinë, historinë dhe gjeografinë e vendit tonë dhe të huajën që në rininë e tij.

I pasionuar pas arkeologjisë dhe artefakteve, të cilat i ndeshi që në vogëli në vendlindjen e tij, ku më vonë ngjalli edhe interes të punonte si ndihmës arkeolog gjatë gërmimeve, që janë kryer përgjatë viteve në Koman e nxitën atë të përmbledh në një dorëshkrim materiale buri-



DRUNJTË / Dy drunjë borxh m'i ke Atdheu im / n' paterica të bredh rrugëve nëpër botë / prej teje të ruaj të vetmin kujtim, / pastaj në kryq m'i ktheni te rrasa mbi kokë." Ndoc Selimi, "Një fjalë me ty", 2019.

more historike e shkencore të pa dëgjua më parë, të cilat i renditi me shumë mjeshtëri në librin e tij "Kultura e Komani dhe komanasit", botuar në vitin 2013.

Një tjetër pasion, me të cili diktonte

shpirtin e tij të mbushur me ndjenje krenarie e malli për vendin e tij e shprehu në vëllimet poetike "Brirët e Hënës" të vitit 2003 në shqip dhe në italisht si dhe në vëllimin me poezi "Si mundem të ikë pa ty", të botuar në vitin 2015.

Tjetër dhunti që e bënte atë ende më të kompletuar si MJESHTËR e njeri plot kulturë ishte edhe "zanati i babës" siç e quante ai punimet me dru, ku në pranverën e vitit 2018 hap ekspozitën vetjake të punimeve me dru në Tiano të Italisë, e cila mori edhe vëmendjen e mediave lokale në atë zonë sidomos me kryeveprën "Britma e Emigrantit", e cila mbarte edhe një mesazh mjaft kuptimplotë.

Në vitin 2019 boton dy përmbledhje me foto nga përvoja e punës në Itali të titulluara "Nën dritën e përvojës" me foto-imaže nga qendra "Në ndihmë të Nënës dhe Fëmijës" si dhe broshurën "Ekspozita me dru e mbajtur në Tiano - Itali" me foto, dëshmi dhe fakte të patjetërsueshme me vlera të larta kulturore.

Ndoc Selimi, babai i dy djemve, ishte

POR....

Ah ky "pori", sa gjëra mbar të mbi vetë. Nga data 14 gusht 2020, Profesorin e nderuar Kolë Progni nuk e kemi ma midis nesh. Ai fluturoj për në botën tjetër. Vdekja e pamëshirshme e rrëmbeu, por jeta e tillë është, ajo është e pamëshirshme. Tashmë ai do ti mungojnë bashkë-shortes Marie, familjarëve, shokëve miqëve dhe dashamirësve të

shumtë. Nuk do ta shikojmë më duke ecur rrugëve të qytetit me atë hapin e tij ritmik, të qetë dhe të sigurtë. Kolë Progni do ti mungojë kabinetit tij të punës, tavolinës së intelektualëve, tavolinës së kuvendimit shoqëror, odës malsore, bjeshkës e vrrinit, malit dhe fushës, nxënësit dhe studentit, gëzimeve dhe hidhërimeve, bisedave plot humor e dashamirësi, do tu mungojnë pleqëve në takime të rastësishme dhe të planizuara, do të mungojë në studio e

para kamerave a mikrofonëve, në sesione e trajtime shkencore, në promovime librash, e shumë e shumë të tjera. Por Profesorin do tu mungojnë atyre që mëndjen dhe zemrën ua pati vënë në dispozicion, Alpeve Shqiptare. Me ndarjen nga jeta të studiuesit të tyre aq pasionant dhe me vërtetësi shkencore, edhe vetë Alpet do të jenë më të mangëta, por do ta ruajnë në gjirin e tyre gjurmën ku vuri këmbën, ku vuri dorën, ku u mbështet, ku pushoi apo

mori një sy gjumë për tu shlodhur.

Prehu i qetë Profesorin e gjeografisë, Kolë Progni, se bëre më të mirën e mundshme. Kujtimi Yt do të jenë shëmbull pozitiv në breza. Njerëzit e mirë nuk vdesin pse varrosen, por vdesin kurr harrohen. Emri dhe puna e Kolë Prognit do të jetojnë gjatë, shumë, shumë gjatë.

Luigj SHYTI
gusht- 2020

MORT I DALUN MENDËSH

Elegji për Kolë Prognin, ndarë nga jeta 14 gusht 2020

VËLLAU IM, O VËLLA

Ç'është ky mort,
ku të gjallët
nuk shihen
me të gjallët
vëllau im,
o vëlla.

Ç'është ky mort,
ku të gjallët
nuk ndahen
me të vdekunit,
vëllau im,
o vëlla.

Me ashkla frike
po bëjmë arkivole,
e vdekjen
t'tanë e kemi ndër sy,
vëllau im,
o vlla.

Yjet numëroj
në çdo muzg
e çdo natë,



Kolë Progni, Marie Progni, Gjin Progni

nga një yll më mungon,
në qiellin e atit tim,
vëllau im,
o vlla.

T'tanë ditën
shkulma
zjarr - dielli
mora
me djegë vdekjen,
se
nuk duroj gjamë

në sinorët e dheut tim,
por vdekja s'paska vdekje
vëllau im,
o vlla.

Që sot
Me vdekjen
n'gjak
do jem përjetë
vëllau im,
o vëlla.

Vëllau im
O vëlla.

Gjin Progni
14.8.2020

**CILA FJALË TË MBETI
PA THANË...**

N'cilin yll tash po pushon,
mësues i madh për gjeografinë,
cila bjeshkë për ty loton,
cila zanë, cila çetinë?

Cili mriç, a cila kreshtë,

cili log, cila ograjë
cili krue i ftoftë si bora,
cila qafë, a cila majë?

Diell i nadjes, a i mbramjes,
a loton e bukra hanë,
për kë ishte loti i fundit,
cila fjalë të mbet pa thanë?

Për ty bjeshka u vesh në zi,
gjithka e pate shkelë me kamë,
djalë për ty është lis i malit,
çikë për ty, e bardha zanë.

Varr për ty është një re' bjeshke,
përmbi të, je pllumb i bardhë,
je bylbyl, je dallëndyshe,
Delikajde, që çel n'Maj.

Profesor, pusho i qetë,
Shpirti yt i gjanë si det,
Si fllad bjeshke ke me mbet,
T'çon Zoti, ku t'dush vet.

Marash Lekndreaj
Shënim: titujt janë të redaksisë

edhe një familjar tepër i përkushtuar. Së bashku me bashkëshorten e tij Prendën, një intelektuale dhe njeri me virtyte të larta njerëzore kane ditur ti rritin fëmijët e tyre në mënyrën më shembullore, çka vihet re edhe nga afrimin dhe dashurin e pamasë e nuseve dhe fëmijëve duke i lumturuar pafund gjyshërit e tyre. Kjo paqe e brendshme shpirtërore si dhe dashuria për vendin bëri që Ndoc Selimi me bashkëshorten, Prendën të kthehen në atdhe për ti kaluar vitet e pensionit dhe pleqërisë në shtëpinë e tyre në Tiranë.

Megjithëse me një mijë probleme shëndetësore, të cilat shpesh i rrezikonin seriozisht jetën, nuk e ndalen për asnjë çast egon e tij për dije, studim dhe afrimet me njerëzit që e rrethonin. Miqësitë e tij fillonin që nga fëmijët e bashkësia rom, të cilëve me humanizëm të pashoq në vend të lëmshës që i kërkonin u ofronte pije dhe ushqim, e deri tek akademikët më të shquar vendas dhe të huaj, të cilët i nxiste vazhdimisht të kishin një vëmendje të shtuar ndaj Shqipërisë e në veçanti vendlindjes së tij, Komanit.

Ndoc Selimi vitet e fundit ishte shumë aktiv në përditshmëritë e tij, në studime, dorëshkrime e hulumtime, të cilat i gjejmë në botime gazetash, revistash e mediash elektronike apo rrjete sociale ku ka marrë edhe vlerësime pafund, ndër to të botuara edhe në gazetën "Dukagjini", ku është mirëpritur vazhdimisht si pasurues me vlerë duke marrë nga lexuesit edhe një vëmendje të veçantë.

Çdo shkrim i tij ka pasur me të vërtetë vlerësime të shumta pasi në secilin dorëshkrim ai sillte një copës histori apo ngjarje të vërtetë ku e nxiste lexuesit edhe për mendim kritik. Në shenjë falënderimi, mirënjohje dhe vlerësimi për kontributin e dhënë ndaj trevës dhe gazetës tone, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" i ka dhënë atij titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", me vendim Nr. 185, me 9 prill 2014, me motivacion: "Për punën shkencore që ka bërë në hulumtimin, studimin e botimin mbi kulturën e Komanit"

Ndoc Selimi ishte një hulumtues i pa ndalur në çdo fushë, por veçanërisht në fushën e historisë, për të cilat ka shumë



Ndoc Selimi, në stërvitjen "Oplasi-95", rrethi Hasit!

mirënjohjeje dhe vlerësime për merita të pashoqe, për kontribute të ndryshme si dhe i gjendur afër studiuesve të rinj e jo vetëm. Ai bashkëpunonte me të gjithë duke i orientuar me dorëshkrime autoresh të ndryshëm në studimet e tyre hulumtuesit, miqtë e tij ku shpesh i sugjeronte edhe për referenca, gjë që e bëjnë atë ndër studiuesit më humanitar e më të veçantë

të kohës.

Hulumtimet dhe studimet e tij nuk i ndali dot as pandemia famëkeqe globale e kësaj pranvere, pasi gjatë gjithë periudhës së diferencimit social dhe karantinimit të popullatës, ai punoi fort për një studim tejet të vlefshëm për Trevën e Pulatit (Pulatit), të cilin kërkonte ta pasuronte me sa më shumë referenca shkencore gjë



Bulgazë, janar 1997, në ndihmë të aksidentuarve në Ternovë të Dibrës, ku shkuam me dy helikopterë dhe u fiksuam në këtë foto. Nga e majta: Sotiraq Pina, Agim Qesaraku, Ndoc Selimi, Agim Nerguti (përkulur) Fatmir Kertalli dhe Vebi Lala.

që ja doli ta përfundonte me sukses e ta bënte gati për botim. Por fati paska rezervua diçka shumë të dhimbshme për jetën e tij.

2020-ta për Ndoc Selimin nuk erdhi vetëm. Ai solli me vete edhe vdekjen tragjike të tij duke shuar në mes ëndrrat dhe pasionin për të dhënë sa më shumë nga vetja, për vendin dhe njerëzit që e rrethonin.

Megjithëse vitet mbi supet e tij ishin të shumta, Ndoc Selimi me të drejtë u vlerësua nga miqtë e shumtë, në moshën ma t' mirë të burrave, ndaj vdekja e tij la pas dhimbje, lot malli e një boshllëk shoqëror që vështirë të gjinden një njeri t'ia zëvendësoje atë në mjedisin social ku punoi e veproi ai.

Lajmi i vdekjes së tij na tronditi i të gjithëve, çka u vu re edhe në rrjetet sociale ku vërshuan statuse e komente pafund nga miq e të afërm të cilët veç vlerësonit për këtë mik, shok e familjar e ngushëllonin njëri-tjetrin me dhimbje të madhe.

Si pasojë e këtij realitetit që na kush-tëzon qëndrimin tonë në distancë në këto ditë të vështira të prezencës së pandemisë nder ne, e në pamundësi pjesëmarrjeje në përcjelljen për në banesën e fundit të mikut dhe njeriut të çmuar, Ndoc Selimi, ne redaksia e Gazetës "Dukagjini", në emër edhe të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" i shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes së tij, miqve të shumte dhe të afërmeve të tij të shpërndarë kudo nëpër botë.

Ndoc Selimi kaloi në amshim fizikisht, duke lënë pas kujtimet dhe një pasuri të rrallë humanizmi e mirësie të shpërndarë ndër ne. Sukseset dhe dëshmitë e tij në punimet shkencore e sociale do jetojnë përgjithmonë ndër ne për t'na kujtuar këtë Burrë të Madh nga Komanit.

Ndoc Selimi, i lehte të qoftë dheu i Komanit, që aq shumë e doje!

Ndoc Selimi, i përjetshëm kujtimi i jetës, punës dhe veprës suaj!

Pushofsh në paqe bashkëpunëtor dhe miku i ynë, Ndoc Selimi!

**Përgatiti Ndue Sanaj,
Rita Shkurtaj e Zef Nika**



Shumë filma dhe dokumentare u realizuan me ndihmën e efektivit të aviacionit, me helikopter. Një nder këto është edhe filmi "Gjuetia e Fundit"



Lusia Deasy Herlina: Kamu adalah seorang bapak yang baik dan hebat... Byk Tugas dan perutusan yg sudah kamu lakukan.. Ini adalah foto yg pernah kamu kirimkan.. untukku... Beristirahat dengan damai disurga temanku... Ndoc (Ti je një baba i mirë dhe i madh.. Shumë detyra dhe vendime që ke bërë.. Kjo është fotoja që ke dërguar.. për mua.. U prefsh në paqe në parajsë miku im, Ndoc)

LAZER STANI PËR DIELLIN: KOLIQI DHE CAMAJ, MAJA TË LETËRSISË SHQIPE

Shkrimtari Lazër Stani komenton ekskluzivisht për gazetën Dielli, Organ i Federatës Panshqiptare të Amerikës VATRA, Neë York, debatin mbi figurën e Martin Camajt dhe Ernest Koliqit ku shprehet se dokumentet dhe dosjet e përpiluara nga Sigurimi i shtetit, ky aparat monstruoz dhe kriminal, nuk mund të trajtohen si dokumente historike. Sigurimit nuk i ka interesuar kurrë e vërteta, po vetëm goditja, eliminimi, asgjësimi e diskreditimi i atyre që ai i konsideronte si kundërshtarë politikë të regjimit. Me Lazër Stanin bisedoi gazetari i Diellit Sokol PAJA.

BALTË MBI ERNEST KOLIQIN DHE MARTIN CAMAJN. PSE PIKËRISHT SOT KY DEBAT?

Nuk mund të them se është debat. Në këtë rast nuk ke se për çfarë të debatosh. Në këtë rast vetëm mund të refuzosh me përbuzje, riciklimin e akuzave të hartuara nga Sigurimi i Shtetit Komunist që synonte të denigrojë dhe të defaktorizojë dy prej personaliteteve kulturore më të rëndësishëm shqiptarë në shekullin e shkuar. Është një praktikë e njohur kjo e përdorur nga shërbimet sekrete Lindore, ndaj personaliteteve kulturore disidentë, që nuk pajtoheshin me regjimet e dhunshme të instaluar në këto vende. Vlerësimi për Ernest Koliqin, Martin Camajn, por edhe Arshi Pipën, Petro Markon e ndonjë shkrimtar tjetër nuk mund të bëhet duke përdorur trillimet e Sigurimit të Shtetit ndaj tyre. Vepra e tyre letrare është dëshmia më e mirë e personalitetit të tyre letrar të padiskutueshëm, por edhe

dëshmi e atdhedashurisë, e lidhjes se tyre shpirtërore me kombin dhe gjuhën shqipe. Joseph Brodsky shkruan se “për shkrimtarin ekziston vetëm një lloj patriotizmi, qëndrimi i tij ndaj gjuhës.”



Shkrimtari Lazër Stani

Nëse i shohim në këtë kontekst, unë nuk di patriotë më të mëdhenj se Koliqin dhe Camajn. Të dy kanë shkruar një shqipe të mrekullueshme. Nëse e lexon krijimtarinë e këtyre dy shkrimtarëve, gjen një lidhje shpirtërore të fuqishme me gjuhën, arketipin, shpirtin dhe identitetin shqiptar, të pa ndotur nga rrjedhat e historisë. Vetëm një njeri që e do shumë vendin e vet, gjuhën e vet, kombin e vet, mund të shkruajë një letërsi të tillë. Në Shqipëri

nuk kemi shumë gjëra për të cilat mund të krenohesh, por emrat e këtyre dy shkrimtarëve, gjithmonë më kanë bërë të ndjehem krenar për vendlindjen time, vendin tim.



Sokol Paja

shqipe. Duket se “studimi” i prezantuar me dokumente të manipuluar dhe raporte të shkruara nga Sigurimi” është vetëm vazhdim i punës së nisur shumë vite më parë për të goditur këto personalitete, që me emrin dhe veprën e tyre i bënin hije shkëlqimit të rremë të diktaturës. Unë mendoj se dokumentet dhe dosjet e përpiluara nga Sigurimi i Shtetit, ky aparat monstruoz dhe kriminal, nuk mund të merren si dokumente historike. Sigurimi

it nuk i ka interesuar kurrë e vërteta, po vetëm goditja, eliminimi, asgjësimi e diskreditimi i atyre që ai i konsideronte si kundërshtarë politikë të regjimit. Dosjet e përpiluara prej tij janë të mbushura me shpifje, intriga, shtrembërime, falsifikime e manipulime të së vërtetës. Ato dosje vetëm se dëshmojnë se sa kriminal, monstruoz dhe antinjerëzor ishte regjimi në të cilin kemi jetuar; një ferr për njeriun dhe një parajsë për të ligun, kriminelin, të pashpirtin, intrigantin, manipuluesin, gjithfarë lloj mostrash që për fat të keq toka jonë i ka prodhuar me shumicë.

ÇFARË PËRFAQËSOJNË CAMAJ E KOLIQINË LETËRSINË EKULTURËN SHQIPTARE?

Koliqi dhe Camaj janë individualitete krejt të veçantë të letrave shqipe, vijnë si zë autentik i shpirtit shqiptar, të pa ndotur e të pa përcudnuar nga masakra që iu bë kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet. Është kjo arsyeja ndoshta që ata urrehen nga bartësit ende aktivë të ideologjisë së diktaturës.

A E DËMTON SHOQËRINË DHE SHKENCËN KJO HAPJE ARKIVASH NGA NJERËZ JO KOMPETENTË?

Shoqërinë e dëmton sigurisht. Akte të tilla poshtëruese i bëjnë njerëzit të demotivohen, të ndjehen të zhgënjyer në vendin e tyre. A këta jemi ne? Nëse jemi kështu, e meritojmë këtë fat që kemi, ndaj hajt të ikim nga sytë këmbët, të shpëtojmë kush mund të shpëtojmë, në mos veten, të paktën fëmijët. Ndërsa për shkencën është vështirë të flitet. Ajo qëndron përtej këtyre banaliteteve.

ÇDO TË THOTË TË SULMOHEN MITET LETRARE TË NJË KOMBI?

Historia jonë është e mbushur me barbarizma të tilla. Është përçmuar letërsia e vjetër shqipe dhe krijuesit e saj, autorët e Rilindjes, Faik Konica dhe Gjergj Fishta, At Anton Arapi dhe Ernest Koliqi e shumë e shumë shkrimtarë të tjerë. Komunizmi si filozofi në ADN-në e vet ka urrejtjen, sepse është i mbështetur mbi urrejtjen klasore dhe konfliktin që lind midis klasave të një shoqërie për shkak të kësaj urrejtjeje. Kjo ka sjellë shumë shkatërrime në vendin tonë, Shqipërinë. Dhe që për fat të keq është ende e pranishme, si sindromë, si lëngatë, që bren vlerat dhe virtutet e kombit. Një komb matet me njerëzit e tij të shquar, shkruante Ernesto Sabato. Nëse ne si komb i asgjësojmë njerëzit tanë më të shquar, e në mes tyre edhe Koliqin e Camajn, atëherë me çfarë do të matemi, me partizanin e vogël Velo? Megjithatë, në fund dua të shtoj se letërsia e mirë është superiore, është e paasgjësueshme. Të tillë janë edhe Koliqi e Camaj si autorë të një letërsie të tillë.



NJË STUDIM MONUMENTAL SHKENCOR MBI DISA FIGURA KYÇE NACIONALE SHQIPTARE GJATE SUNDIMIT OTOMAN

(Mark Palnikaj, "KLERIKË ATDHETARË" TIRANË 2020)

Dekadat e fundit kanë parë dritën e botimit shumë libra edhe në lëmin e historisë. Nuk ka asgjë të keqe në pamje të parë, por e keqja është se shumë prej tyre kanë të dhëna të ashtuquajtura shkencore të marra andej-këndej, ose përmes opsionin copy-paste nëpër rrjete sociale.


Po krenjt ndryshe ndodh me studiuesin dhe historianin Mark Palnikaj. E kemi parë në përpjekjet e tij të pafundme nëpër arkiva. Vitet e fundin stacionin e tij e ka vendosur në Vatikan, kur ka një ndër arkivat më të rralla e të rëndësishme të botës. Ndaj Mark Palnikaj duhet lexuar dhe dëgjuar. Ai është enciklopedi e gjallë, pasi hulumton arkivat, merr referenca i krahason dhe më në fund del produkti i pa kontestueshëm nga askush. Pikërisht edhe libri më i fundit "Klerikë Atdhetarë" duhet parë me kujdes pasi i shërben shumë historisë së shqiptarëve.

Për të vijuar më tej studiuesi Mark Palnikaj, këto ditë ka dalë me një libër studimor mbi figurat emblematike kombëtare: Pjetër Bogdani, Shtjefën Gaspri, Don Pal Zogaj dhe Shtjefën Gjeçovi. Duke pas parasysh edhe faktin që këtë vit, në dhjetor mbushen 330 vjet nga vdekja e Pjetër Bogdanit, Po ashtu këtë vit mbushen edhe 240 vjet nga vdekja e Don Pal Zogajt dhe 90 vjet nga vdekja, gjegjësisht vrasja e Shtjefën Gjeçovit, themi se pesha e këtij studimi është krahas e peshës shkencore edhe e asaj jubilarë.

Palnikaj ka përmbledhur të dhënat e njohura deri më tani dhe ato të reja, nga hulumtimet e tija, duke na dhënë një pasqyrë të gjere mbi jetën dhe veprën kombëtare, fetare si dhe gjenezat famil-

jare të klerikëve në fjalë, që nuk reshtën së vepruari për të ndriçuar kombin e tyre që ishte ferrosur nga pushtimi otoman.

Libri hapet me një shkrim të autorit të botuar me titull "Një kujtesë për Qeverinë e Kosovës, Ministrinë e Kulturës së Kosovës..." në gazetën "Nacional", nr. 532, datë 24 nëntor 2019, me ç' rast hapë një temë dhe kërkesë me interes të posa-



çëm që do të duhej të shqyrtohej edhe nga qeveria e Kosovës, shqyrtimi i mundësisë së kthimit të varrit të Bogdanit, që ndodhej në katedralen e vjetër të cilën, pas vdekjes së tij, osmanët e shndërruan në xhami.

Përtej hapjes së kësaj teme që padyshim është për tu vlerësuar, autori na jep pasqyrën e prejardhjes, shkollimit, shërbimit fetar si klerik, veprimtarisë letrare e të tjera, si dhe veprimtarisë patriotike në organizimin dhe udhëheqjen e kryengritjes shqiptare, që së bashku me forcat austrohungareze, arriti ta çlirojë dhe mbajë Kosovën jashtë sundimit të egër

Osman për rreth dhjetë vite.

Studiuesi Palnikaj pasi ka shteruar studimet e njohura deri më tani mbi Pjetër Bogdanin, duke shkruar më tej me shfrytëzimin e dokumenteve, sidomos të atyre të arkivit të Propagandës Fide (APF), dhe atyre të terrenit, ka arritur të na jap një pasqyrë më të plotë studimore mbi të gjitha aspektet që lidhen me këtë

na zhytë në të rejtat e ndriçuara mbi një fytyrë tejet të rëndësishme dhe pothuaj të panjohur nga ne siç është Don Pal Zogaj, ndryshe siç na thotë autori i librit, kleriku që përgatiti gramatikën e shqipes në vitin 1776, i njohur ndryshe si Pale Bria.

Më tej libri përmban studime të autorit Mark Palnika mbi figurën tjetër shumë të rëndësishme kombëtare dhe klerikale, At Shtjefën Gjeçovi. Ai ka trajtuar aspekte të ndryshme të veprimtarisë së Gjeçovit dhe po ashtu ka kontribuar me vështrime analitike mbi "Kanuni i Lekë Dukagjinit", një veprë për madhore e mbledhur dhe e ndërtaur nga Gjeçovi i cili është vrarë nga pushtuesit serb, pikërisht për shkak të veprimtarisë atdhetare shumëdimensionale.

Më duhet të them se ky libër është një nga librat e rrallë që temat përkatëse, respektivisht figurat përkatëse dhe veprimtaritë e tyre i trajton thellësisht në linjë shkencore. Konsideroj që libri si tërësi mbase duhet edhe të ndërjegjësoj klasën politike.

Të paktën Prishtina e ka për borxh që në sheshet e saja, krahas Gjergj Kastriotit, ta vendos edhe shtatoren e Pjetër Bogdanit, pasi pjesa mbase më e rëndësishme e veprimtarisë nacionale shqiptare e tij është zhvilluar në rrethet e Prishtinës.

Autori i librit, Dr. Mark Palnikaj
Nga Mr. Sc. Murat Ajvazi, Zvicër

INTELIGJENCA EMOCIONALE

* Çfarë është inteligjenca emocionale?

J.Ë. Goethe (1749-1832), ka folur për formimin e zemrës. Çfarë kishte menduar? Formimin emocional!? Inteligjencën emocionale? Ndoshta!

Megjithatë u deshën gati dy shekuj që të sqarohej inteligjenca emocionale e njeriut.

Ideja për inteligjencën emocionale u hodh në vitin 1990 nga psikologët amerikanë, John D. Mayer dhe Peter Salovey. Idetë e tyre u bënë të njohura nga libri bestseller me titull „EQ-Emocionale Intelligenz“, i autorit Daniel Golemans.

Me EQ mendohet "Kuota e inteligjencës emocionale".

Në të kundërtën e IQ "klasike", inteligjenca emocionale, nuk ka të bëjë me aftësitë matematike, kimi apo fizikë. Shumë më tepër mendohet aftësia e të kuptuarit emocionalisht, të vetvetes dhe tjetrit. Është ajo që ka menduar Goethe, formimi i zemrës.

Njerëzit me kuotë të lartë të inteligjencës emocionale, janë në gjendje të vlerësojnë dhe ndikojnë mirë, ndjenjat e veta, dhe të tjerëve. Kjo do të thotë, që një person, me kuotë të lartë inteligjence emocionale (EQ), është shumë më i suksesshëm në punë dhe

shoqëri, se ai me një shkallë të lartë kualifikimi profesional, dhe me një masë të lartë të IQ, por që ka një shkallë të ulët të EQ.

Sipas Mayer dhe Salovey, njerëzit me një EQ të lartë, dallohen në gjashtë veçori nga të tjerët:

1. I kontrollojnë emocionet e veta.

Në çdo kohë dhe rrethanë, janë në gjendje që t'i kontrollojnë dhe ndikojnë gjendjen e tyre shpirtërore dhe ndjenjat. Shpesh kjo gjë kryhet nëpërmjet „dialogut të brendshëm“. Në këtë mënyrë, ata kanë shumë më tepër mundësi, që t'i kontrollojnë ndjenjat e tyre, se një person me IQ (kuotë të inteligjencës) më të lartë. Kjo është shumë e rëndësishme, në raste „tërbimi“ apo zhgënjimi të madh. Ata nuk i përcjellin ndjenjat e tyre tek të tjerët. Jo vetëm që nuk prodhojnë konflikte me të tjerët, por janë shumë më të aftë për zgjidhjen e tyre, në mënyrë paqësore.

2. Kanë aftësi vetëmotivuese.

Njerëzit me inteligjencë të lartë emocionale, në situata të vështira, qëndrojnë gjakftohtë dhe vetëmotivohen për zgjidhje të arsyeshme. Gjakftohtësia i ndihmon ata për të gjetur zgjidhjen e arsyeshme. Kjo aftësi, vetëmotivuese, i bën kreativë në kërkim të diçka ndryshe. Ata nuk e humbasin besimin, dhe nuk dorëzohen, nëse dështojnë diku.

figurë aq të madhe, që për shumë arsye mund të renditet më e madhja pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, gjatë tërë kohës së sundimit Osman këtu.

Figura tjetër që studiuesi Palnikaj ka studiuar është ajo e klerikut atdhetar Shtjefën Gaspri, i cili siç na thotë autori, është i njohur në shkrimet në gjuhën italiane si Stefano Gaspari dhe në atë latine si Stephanus Gasparis, që sipas autorit, në Shqipëri është shkruar fare pak për jetën dhe kontributin e tij në dobi të atdheut.

Krahas të dhënave të reja mbi dy figurat e shquara kombëtare dhe klerikale si Bogdani dhe Gaspari, Palnikaj vazhdon të

3. Bashkëndejnë me të tjerët.

Kanë aftësi që të kuptojnë dhe ndiejnë atë që ndiejnë dhe vuajnë të tjerët. Nuk qëndrojnë indiferent ndaj ndjenjave të të tjerëve, madje i ngushëllojnë, motivojnë dhe përkrahin ata. E respektojnë mendimin e tjetrit, edhe nëse nuk është fare mendimi i tyre.

Kjo do të thotë se ata kanë një „mekanizëm“ të pasur ndjenjash. Në këtë rast, bëhet fjalë për "empati".

Njerëzit të pajisur me empati, janë kudo të suksesshëm.

4. Janë të pajisur me kompetencë sociale.

Njerëzit me inteligjencë të lartë emocionale, kanë aftësinë e vendosjes së kontakteve sociale të shpejta. Krahas kësaj, janë shumë të kujdesshëm dhe të aftë për të kultivuar dhe ruajtur për kohë të gjatë shoqërinë dhe miqësinë me të tjerët. I mjeshtërojnë me shumë talent konfliktet me të tjerët.

E gjejnë shumë më thjeshtë partnerin dhe jetojnë për kohë të gjatë, ndoshta për gjithmonë, bashkë në harmoni.

5. Janë partnerë të mirë bisedimesh.

Njerëzit me një EQ të lartë, i respektojnë të tjerët dhe i dëgjojnë me vëmendje. Kjo bën që ata të jenë partnerë të mirë bisedimi. Artikulojnë shumë mirë dhe i japin partnerit të kuptojë, se e dëgjojnë me vëmendje dhe tregojnë ndjenja ndaj tij. Janë në gjendje,

që pas bisedës, të rekomandojnë zgjidhje të arsyeshme, pa e ndikuar aspak bashkëbiseduesin.

6. Kanë një imazh të vërtetë mbi veten e tyre.

Njerëzit me një EQ të lartë, janë në gjendje që ta vlerësojnë realisht veten e tyre.

E kuptojnë veten e tyre, nevojat e harmonizojnë me mundësitë, i njohin ndjenjat, qëllimet, dhe në çdo kohë e dinë se çfarë ju duhet, dhe çfarë nuk iu duhet, për të arritur atë që duan.

Sistemi i nxitjes dhe frenimit, tek ata, është gjithmonë në ekuilibër. Për çdo rast, janë të vetëdijshëm.

7. Janë pjesë e zgjidhjes, dhe jo e prodhimit të konflikteve.

Njerëzit me EQ të lartë, ndryshe mund të mendohen, të urretë, të mençur. Si të tillë ata nuk prodhojnë kurrë konflikte. Nëse ndodhen në mes konfliktesh, të prodhuara nga të tjerët, tregojnë gatishmërinë dhe aftësinë për zgjidhjen e tyre. Mendimet e tyre, gjithmonë janë më të mirat e mundshme. Të paktën, për çdo rast, janë të ndershme, pa prapaskena.

*Lekë Imeraj - shkrimtar, përkthyes, publicist

LUFTA E HARRUAR E KOPLIKUT, NË 100 VJETORIN E SAJ

Bazuar mbi fakte të vërteta burimore të historiografisë shqiptare, apo relacioneve zyrtare e jo zyrtare si dhe të trashëgimisë gojore, Lufta e Përgjakshme e Koplikut, njihet si qëndresa më heroike e popullit shqiptar, ku pavarësisht humbjeve... "fitorja u takoi shqiptarëve që bënë një luftë të drejtë dhe mbrojtëse" - pohoi në fjalën e tij përshëndetëse z. Ramadan Likaj, ish Kryetari i Bashkisë Koplik të Malësisë së Madhe, në simpoziumin shkencor të organizuar me 5 tetor 2009.

E solla në vëmendje këtë simpozium si të vetmen përkujtimore për një referencë të mirëfilltë shkencore të deri tanishme si dhe për faktin se ky vit përkon me 100 - vjetorin e kësaj qëndrese heroike të malësoreve në mbrojtje të trojeve etnike kundër pushtuesit më të egër Serbo - Malazez. Ngjarje historike kjo, që ka merituar dhe meriton një vëmendje të shtuar jo vetëm nga malësorët, por edhe nga mbarë qarqet akademike shkencore nacionale zyrtare e jo zyrtare.

Megjithëse e nxitur nga politikat dashakeqëse të ndërnacionale, të cilët u detyrohen shumë çka shqiptarëve, kjo luftë është cilësuar nga diplomacia evropiane e asaj kohe si një nga luftërat më të përgjakshme të popullit shqiptar dhe qëndresa më e pathyeshme heroike e malësoreve trima kundër fqinjëve gjakatarë Serbo-Malazez, të cilët edhe pse të mbështetur nga klanet politiko - Ruse, arritën të depërtojnë në malësi, jo me force, por me dredhi, duke thyer kështu shtigjet dhe pritat e vigjilencës së vullnetarëve malësor.

Ky vit jubilar meritonte një vëmendje të shtuar nga pushteti vendor dhe ai qendror, pasi të vlerësosh LUFTEN E KOPLIKUT, është një obligim mbarë nacional, për faktin se, falë kësaj lufte, të gjitha këto territore të lara me gjak në atë qëndresë heroike gjenden brenda hartës së sotme politike të Shqipërisë.

Bazuar në një nga dorëshkrimet e Gjon Zekës "Nëpër lufta për liri" të përmbledhura në librin "Kopliku në vitin 1920 - 1921", del në pah edhe fakti se si serbo - malazezët, në pamundësi force për të thyer qëndresën e malësorëve, përdoren serish dredhitë. Të ndihmuan nga kaçakët heretikë, të cilët thyen lidhjet e malësisë, duke u shtirur dhe shitur më parë, u hapën dy shtigje pushtuesve të huaj të hynin në Kastrat dhe krahinat përreth "kah Qafa e Padigorës dhe Qafa e Gëlqeres së brisë së Veleçikut tue marre Shkrelin".

Kjo lëvizje tinzare dhe djallëzore i gjeti malësorët jo fort të përgatitur, çka i dha përparësi forcave sllavo-malazeze për të pushtuar një pjesë të mire të malësisë e duke kthyer Kastratin në një vatër të përgjakur e të shkrumbuar gjatë marshimit të tyre drejtë Shkodrës. Me të mbërritur në Koplik këto forca barbare, u ndeshën

heroike, u dëftua edhe njëherë uniteti i pa lëkundur ndërmalësor dhe ai mbarë shqiptar.

Të habit fakti se si kjo luftë e përgjakshme është lënë në hije të plotë nga mediat e shkruara të asaj kohe, relacionet zyrtare e jo zyrtare e deri tek materialet shkencore, të cilat vende-vende i kapërcejnë këto dy vite duke i lënë pa një dëshmi historike, ose kalohet me një përshkrim krejt empirik. Ajo që të habit ende më shumë është se, edhe ato pak materiale të shkruara të asaj kohe janë të censuruara nga regjimi zogist, i cili qëllimisht dhe me tendence nga ai mllef (urrejtje) që mori ndaj malësoreve dhe organizatoreve, pikërisht në këtë luftë rreth përplasjes që pati me ta, ku desh i mori dhe jetën si i dyshuar pro sllav e pluhurosi këtë ngjarje të lavdishme historike me mllefin e tij hakmarrës". Prele Milani. "Atentati që tronditi dy shtete"

Veç kësaj po ti referohemi edhe historiografisë shqiptare mbetemi serish të zhgënjyer, se sa empirike paraqitet kjo luftë. E gjitha e përmbledhur në një kapitull të vetëm e me krejt pak material të shkruar. Dhe serish e censuar edhe nga qarqet akademike të kohës së monizmit.

Dhe ajo që i vuri vulën e mos vlerësimit të kësaj lufte, ishte heqja e memorialit (lapidarit) nga Rilindja Urbane prej qendrës së qytetit të Koplikut, duke shuar kështu çdo dëshmi që identifikon gjakun e derdhur të atyre malësoreve dhe vullnetareve trima shqiptar.

Megjithatë dëshmitarët e asaj qëndrese kanë mundur të nxjerrin në dritë shumë fakte e ngjarje të pathëna, duke u dhënë zë të vërtetave historike të asaj qëndrese heroike.

Merita të veçanta për këtë zbardhje kanë malësorët e Malësisë së Madhe, intelektual të Dukagjinit dhe qytetarë të nderuar të Shkodrës, dashamirës të malësisë dhe të vërtetave historike, të cilët i kanë sjell këto kujtime dhe gojëdhëna në formë dorëshkrimesh publicistike dhe li-brash me vlere.

**LUFTA E KOPLIKUT
ZGJOI UNITETIN NDËR
VËLLAZËROR
TË SHQIPTARËVE**

Kushtrimi i kësaj lufte kaloi përtej ma-

leve të malësisë, duke ngjall në zemrat e krahinave të Veriut frymën nacionale dhe vullnetin e mirë për tu gjetë pranë vëllazërisë së këtyre fiseve. Fryme kjo që vuri në lëvizje edhe qarqet akademike e patriotike e deri tek organizmat shtetërore, të cilët u angazhuan edhe fizikisht në këtë qëndresë. Sipas gojëdhënave dhe materialeve të shkruara në të hyrë të muajit gusht, pranë shtabit të mbrojtjes të vendosur në Çezme të Koplikut, në hanin e Zef Luc Mullisit vjen Ministri i Brendshëm Ahmet Zogu dhe Plaku i Maleve, patrioti shqiptar Bajram Curri.

Sipas Nikoll Spathari, «Malësia e Madhe si e njoha unë»

Si pasojë e jehonës së qëndresës dhe vështirësive të panumërta, që përjetuan malësorët në këtë përballje, në ndihmë të tyre u angazhuan shumë vullnetarë, të cilët u thirren në këtë kushtim nga patriotet më të flaktë të asaj kohe, arritën të mirë koordinojnë mësymjet, si dhe të mbajnë të pathyeshme llogoret luftarake. Komandant i Përgjithshëm i forcave Vullnetare u caktua Sulçe Beg Bushati. Nikoll Spathari (po aty).

Megjithëse me pasoja të rënda jetike dhe ekonomike, kjo luftë bëri të triumfojë dhe njëherë uniteti ndër vëllazëror i shqiptarëve, të cilët nuk u tërhoqën deri në pikën e fundit të frymës së tyre.

TË NDEROSH LULFTEËN E KOPLIKUT ËSHTË DETYRË MORALE DHE ZYRTARE E PUSHTETIT VENDOR DHE QËNDROR

Të përkujtosht Luftën e Koplikut, është nderim për gjakun e derdhur të malësorëve trima, vlerësim i asaj ndihme vëllazërore të mikut dhe kujtese historike ndaj barbarizmave të armikut.

26 korriku shënon 100 vjetorin e kësaj lufte dhe nuk vihet re asgjë që identifikon një punë në ecurinë e saj si projekt për ti vënë pikat mbi "i" kësaj kujtese të përmasave dhe vlerave të mëdha historike.

Heshtje totale nga organizmat zyrtarë të pushtetit vendor.

Heshtje edhe nga shoqatat apo institucionet e edukimit, në një kohë kur trumbetohet me të madhe dhe flitet pafund për vlerat e turizmit kulturor.

Paaftësia e nëpunësve zyrtarë, jo kompetent për këtë punë, del haptazi për aq kohë sa arrijnë të sajojnë festa frutash me gjemba dhe të anashkalojnë rëndësinë dhe peshën e vlerave historike e kulturore të Malësisë së Madhe.

Në këtë 100 vjetor, Lufta e Koplikut me gjithë lavdinë e saj, shuhet plotësisht nga kujtesa historike e Malësisë së Madhe, duke u mohuar dhe përbaltur nga arroganca heretike e të paaftëve që hanë dhe flenë në postet e gabuara të administratës së sotme në Malësi.

Përgatiti **Rita Shkurtaç**,
22 korrik 2020



ANTIBIOTIKET - Shpetimtarët e jetës dhe kujdesi për aplikimin e tyre



dr. Ndue Nikaj

Antibiotiket janë preparate medikamentoze (ilaje) që përdoren për shkatërrimin e bakterëve të dëmshme (sëmundje) (sëmundje) (shkaktues). I pari dhe me i fuqishmi ishte Penicilina e zbuluar nga shkencëtari Alexander Fleming- në 1928, një ilaç që beri revolucion dhe mjekoi sëmundjet infektive (ngjitës) të cilat deri në atë moment ishin vdekjeprurës: si skarlatina, meningjiti, dhe me zbulimin e Streptomycines, u luftua dhe Tuberkulozi. Antibiotiket janë baze natyrale e prodhuar nga mikroorganizma të tjerë, përgjithësisht nga mykra. Antibiotiket vrasin bakteret me dy mënyra: duke shkatërruar murin qelizor të bakteres (pra shkatërrojnë qelizën bakteriale) ose duke bllokuar aktivitetin (veprimtarinë) jetësorë të tyre ose dhe me ane të frenimit të rritjes duke i lenë detyrën për shkatërrim përfundimtar (të plote) sistemit imunitar mbrojtës të organizmit. Sipas të dhënave italiane 1.5 milion vete përdorin antibiotike për të mjekuar infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes, (angina, infeksion të veshit) ose urinuar.

Armiku i antibiotikeve janë vete Bakteret

Të gjithë antibiotiket janë njëloj (te barabarte) -kemi antibiotike me fushe (spektër) të gjerë veprimi, që mjekojnë shumë infeksione të organizmit dhe antibiotike me spektër të kufizuar (të ngushte) ato që kanë veprim më të shënuar (me target të përcaktuar); Pra ajo që nuk ndryshon është shenjtëri, këto ilaje janë me dobi vetëm për të shkatërruar Bakteret por nuk kanë efekt (janë pa dobi) kundër Viruseve;

Bakteret janë mikroorganizma (agjent sëmundje shkaktues) të kudo ndodhura në çdo cep të globit tokësor, nën tokë ose në ujë.

Nga ana tjetër ka dhe mikrobe të ashtuquajtura të mire (miqësore) saprofitë, që nuk shkaktojnë infeksione (sëmundje), pra nga e kundërta e asaj që mendohej -bakteret sëmundje shkaktuese janë një pjese e vogël e morisë së tyre p.sh: bakteret që jetojnë brenda trupit tone, që janë shumë më tepër se vete numri i qelizave ku strehohen, nuk janë agresiv për to, pra janë miqësorë (saprofitë) duke jetuar në bashkëjetese me organizmin e njeriut pa shkaktuar sëmundje. Kjo flore bakteriale ndodhet kudo në organizëm në lëkure, në gojë, në pështyme, në gryke, në rrugët e frymëmarrjes dhe në radhe të parë në zorrë, ku në aparatit gastro-inesntinal ndodhen mesatarisht 300-500 lloje bakteresh.

Vrasësit (killeret) mikroskopike!

Pavarësisht nga mikrobet miqësorë siç u shpreh, ekzistojnë dhe mikrobe të dëmshme ose si quhen pathogen (sëmundjeshkaktues), siç janë në minorance (pakica) kanë aftësi të shkaktojnë sëmundje ose infexion. Këto mikrobe duke u futur në organizëm me mënyra të ndryshme: - me ane të ajrit përfundojnë në mushkëri, ose me ane të ushqyerjes, ose përfundojnë në stomak e zorrë, ose mund të përhapen përmes plagëve e lëndimeve, plasjeve të vogla në lëkure, ose me ane të çpimeve e pickimeve nga insekte, ose me ane të kafshimeve nga kafshët, ose nga parazit të ndryshëm si: malaria nga mushkonja, e cila pas pickimit të të sëmurit e transmeton plasmodiumin tek të shëndoshit dhe shkakton sëmundjen.



Po ashtu, së fundi sëmundja mund të transformohet dhe me ane të jashtëqitjes së kafshëve, ose të njerëzve të sëmure, ose dhe marrëdhënive seksuale si sëmundjet seksualisht të transmetuese deri tek SIDA.

Efektet e tyre mund të jene shkatërrues një baktere, që peshon një të milionët e gramit mund të vrasin balenën që peshon 100 ton (nga që bakteret shumëzohen me miliarda dhe shkatërrojnë gjithë qelizat).

Çfarë janë superbakteret!?

Antibiotiket janë në gjendje të nxjerrin jashtë lojë këto mikrobe vrasëse (killer).

Mirëpo antibiotiket ishin në gjendje ta bënin këtë deri para pak kohesh, tani së fundi që janë përhapur mikrobe rezistente ka ndryshuar situata. Pra, kemi baktere antibiotiko-rezistente, që arrijnë të mbijetojnë, të rezistojnë ndaj veprimit agresiv të antibiotikeve.

Si u arrit që bakteret të forcohen dhe të bëhen **SUPRABAKTER**? Kjo thjeshtë përmes një mekanizmi selektimi natyral.

Të imagjinojmë një grup prej dhjetë (10) bakteresh, që janë të gjithë të njëjta (identik) veç njeri prej tyre, që paraqet ndryshim të vogël (mutacion) të trashëgimisë gjenetike. Pra, te 10 bakteret mund të goditen me antibiotik dhe të vriten veç njërit, që ka transformuar trashëgimin gjenetike (ka mutacion), i cili arrin të mbijetojë, dhe që në këtë moment këto mikrobe pavarësisht antibiotikut kanë aftësi të rriten dhe të riprodhohen brenda 20 minutave. Pra, vazhdon të krijohet popullim bakterial të afte t'i rezistoj shumimit

të antibiotikeve. Dhe për më keq, ky mikroob rezistent mund të transmetojë material gjenetik tek bakteret e tjera qoftë dhe me kontakt fizik. Pra, kështu një numër shtamesh (gjerimesh) bakterial që rezistojnë duke i mbijetuar sulmit antibiotik dhe kjo rritet në mënyrë eksponenciale. Nëse kjo ndodh për bakteret agresivë të dëmshme, organizmi ketë kolonizim bakterial nuk arrin ta shkatërrojë nga, që nuk kemi arme (antibiotike) me afinitet e efikasitet të mjaftueshëm për ti shpartalluar. Kjo rezistencë është zhvilluar me shpejtësi të madhe sa nuk po kemi në kohën e duhur antibiotike të ri efektiv. Tani, së fundi raportohet nga shkencëtarët se është de-shifruar mekanizmi molekular për aktivitet selektiv antibakterial prototipa me përbërës sintetik dhe këto lende imitojnë (përsërisin) peptidet bakteriale të gjendura në sistemet imune biologjike që shërbejnë si "traponuse-zhbiruse" të membranës mikrobiale dhe sikur goditen me breshëri plumbash duke shkatërruar qelizën bakteriale, gjë që e vdes mikrobin. (Raportohet: bashkëpunimi i Universitetit Ilinos et Massachusetts SHBA), ku është sintetizuar një klase antibakteriale këtij lloji.

Por infexionet e shkaktuara nga këto suprabaktere janë në rritje në gjithë botën, kështu në Evropë çdo vit regjistrohen 25 000 vdekje nga këto baktere vetët agresive. Dhe kështu veç tjerash po behet e rrezikshme dhe për ndërhyrjen kirurgjikale.

Por duhet të mos neglizhohet ekzaminimi për përcaktimin e shkaktareve të infeksioneve dhe ndjeshmërisë së tyre me antibiogramë, gjë që ndihmon për të vendosur terapi të përshtatshme me antibiotik veprues. Po ashtu, në infektimin e të sëmurëve ndihmojnë dhe procedurat e ndryshme si kateterizimet urinare, cystoskopii, katerizimi për koronarografi e angioplastike (me vendosje stenti), të cilat mund të mos jene pa rrezik për infexion.

Antibiotiket bëhen rezistente në shume vende nga përdorimi i shumte dhe pa kriter. Sa më shume antibiotike në tregun farmaceutik, aq më shpejt ka zhvillim dhe shumëfishim të baktereve rezistente, kështu rritja e antibiotikoresistencës shton nevojën për antibiotike të ri të gjeneratave të reja, në kohën, që siç u theksua prodhimi i antibiotikeve të rinj efektiv është në krize, gjë që pohohet nga shumë studime të kohëve të fundit.

Pra, del **DETYRË TË PERDORIM MË MIRË ARSENALIN QË KEMI**. Pra, zgjidhjen duhet ta shohim para se gjithash tek personeli mjekësor për një përdorim të akorduar (të miratuar) të antibiotikeve ekzistues. Pra, antibiotiket t'i përdorim vetëm kur janë të nevojshëm realisht dhe jo ti përdorim në raste të lehta-të vrasim mushkonjën me "mitraloz". Nuk ka sens të përdorim antibiotiket në rrufe a grip (ku nuk vepron). Problemet e zakonshme duhet ti përballojmë me durim; është më

mirë të qëndrohet disa ditë shtrire në shtëpi se sa të marrësh një antibiotik jo veprues, pa asnjë dobi. Madje nuk vepron më në të ardhmen dhe po të kesh vërtet nevojë për te.

Mos u vete mjekoni duke marr AN-TIBIOTIK e në farmaci sipas këshillave të miqve apo familjareve, por shko bëni një kontroll tek mjeku juaj se mund të mos kesh nevojë. Duhet të dimë, se fatkeqësisht antibiotike nuk gjen vetëm në farmaci. Ato mund ti marrim me mish, peshk, me shpend, sepse tani me ato sido që komuniteti Evropian i ka ndaluar të përdoren për rritjen e tyre, vazhdojnë të përdoren, aq më tepër për shmangien e infeksioneve në kafshe, shpend, derra etj. Po ashtu po përdoren për pastrimin e shtëpive, lende të ndryshme antibakteriale, por dhe po të jete e nevojshme duhet të përdoret nën kontroll dhe jo me tepricë. Dhe sipas raportimeve të ndryshme përdorimi për shpend, kafshe etj është pak më i vogël se që ato përdoren tek njerëzit. Dhe në këtë mënyrë kërcënohet dhe shëndeti ynë duke u favorizuar zhvillimi i baktereve rezistente që kalojnë nga kafshët te njeriu (PANTOSTI)

Sipas të dhënave italiane 60% e antibiotikeve destinohet për mjekimin infeksioneve të Frymëmarrjes, ku shumica e tyre shkaktohen nga viruset ,ku ndaj tyre nuk ka dobi përdorimi i tyre.

Nga ana tjetër për të mbajtur shëndetin tone në ekuilibër është e rëndësishme që ushqimi ynë të jete i pasur me mikrobe "të mira" si ferment taktikë, si kos, laktobacile, pra te forcojmë sistemin tone mbrojtës.

Tre rregulla të arta për përdorimin e Antibiotikeve!

Mos përdorni antibiotike kundër viruseve si rrufe, grip etj., sepse ato janë të pa dobishme ose madje të dëmshëm-japin efekte anësore, alergji: sëmundje në zorrë si diarre (nga klostridium difficile), mykëza.

Shkoni tek mjeku, vetëm ai vendos me ane të ekzaminimeve ose kulturës për mikrobe me antibiogramë dhe kolaudon për terapinë tuaj.

Dëgjoni mjekun nëse u jep antibiotik!

Vazhdojeni kurën deri në fund dhe merreni dozat e plota për të eliminuar mikrobet e dëmshme, antibiotiku kërkon një afat për të vepruar nga 7-10 dite sipas rëndësës së infexionit. Mos hiqni mjekimin që në përmirësim, sepse është barsi si të mos i kishim marre fare ose më keq akoma se krijon rezistencë. Për çdo veprim pyet mjekun ose farmacistin.

Evito vetëmjekimin (Mos merre antibiotike me iniciativën tende)

Për çdo shqetësim dhimbje gryke, dhembje, veshi, temperatura, mos merr këshilla nga jo kompetent-por shko tek mjeku ose specialisti përkatës,

Përgatiti: Dr. Ndue NIKAJ, Shkodër

“ORË LETRARE”, NË MALËSI TË MADHE

NË PERKUJTIM TË MENDIMTARI MALËSOR QË ARRITI TË LËKUND EDHE PENDËN E ARTË TË SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE

Sa herë që duam t'u kthehemi kujtimeve apo të flasim për të shkruarën, si parantezë mendimi, shpesh vendosim togfjalëshin «na ishte dikur», ku jo rrallë na bëjnë që të ndihemi në faj për pamundësinë për ta kthyer kohën pas, që disa gjëra t'i bëjmë ndryshe, sidomos kur bëhet fjalë për njerëz dhe vende, mbi të cilët veprojnë në mënyrë të pandalshme cikli i jetës dhe faktorët njerëzor, por dhe natyrorë.

Mbi të tilla konture u realizua takimi i “Orës Letrare” në kujtim të jetës dhe veprës së mendimtarit dhe shkrimtarit të talentuar malësor Ramiz Lika nga revista “Fjala” me organizator gazetarin shumë të përkushtuar z. Gëzim Vuçaj ditën e mërkurë, me 29 korrik 2020, në Bar-Restaurant “Rubens”, në lagjen Culaj-Koplik, Malësi e Madhe, ku morën pjesë shkrimtarë, poetë, gazetarë e artistë, të cilët me respekt e mirënjohje të thellë sollën shumë kujtime mbi eksperiencat e tyre me këtë mendimtar dhe malësor model.

Në këtë takim përkujtimor, veç familjes, miqve dhe dashamirësve të shkrimtarit Ramiz Lika, ra në sy edhe prezenca e institucioneve vendore e në veçanti e Kryebashkiakut të Malësisë së Madhe z. Tonin Marina, duke u dhënë një vlerësim ende më të madh këtij intelektual, të njohur ndryshe edhe si romancieri i parë në Malësi të Madhe.

PAK FJALË MBI JETËN DHE VEPRËN E SHKRIMTARIT DHE ROMANCIERIT RAMIZ LIKA

Ramizi u lind me 27 mars 1939 në fshatin Zagorë të Malësisë së Madhe në një familje të thjeshtë me tradita dhe virtyte të larta e në zë për fisin e Shkrelit dhe krejt Malësinë e asaj kohe.

Vitet e para të vegjëlisë ishin tepër të vështira për Ramiz Likën, pasi lidhen

edhe me tranzicionin social ekonomik dhe politik të asaj kohe të kalimit nga shteti i monarkisë nën pushtetin italian, çka çoi në një regres të thellë kulturor, jo vetëm në familjen e tij por në të gjithë Malësinë e Madhe, ku prezenca e luftës nuk lejonte as rimëkëmbjen e saj.

Mësimet e para i mori në vendlindjen e tij në fshatin Zagorë, ku paralel mori edhe mësimet teologjike pranë xhamisë, çka e ndihmoi të bëhet njohës shumë i mirë i gjuhës Arabe, dhunti kjo që e ndihmoi të mësonte përmendësh Kuranin, si dhe t'i shqipëronte kuptimin e çdo fjale.

Më pas, me rritjen e tij, i nënshtrohet shërbimit të detyrueshëm ushtarak për 4 vite me radhë, ku falë marrëdhënieve të mira që kishim aso kohe me rusët, i



Tonin Marinaj, kryetari i bashkisë, duke dhënë certifikatën e mirënjohjes, për Ramiz Likën, bashkëshortes së tij

shfrytëzoi për mësimin dhe perfeksionimin e gjuhës ruse.

Studimet pedagogjike e profilizuan si mësues në degën e gjuhës - letërsisë, degë, të cilën e vlerësoi, jo si profesion, por si një mision të shenjtë, duke u bërë edhe një edukator i përkushtuar për shumë gjenerata nxënësish.

Kontakti i punës me malësorët e tij, apo i disa viteve me më pas edhe me pujanët, i dhanë atij njohuri shtesë mbi kulturën dhe virtytet njerëzore.

Të gjitha këto njohuri bënë që krahas misionit të shenjtë të mësuesit, Ramiz Lika të guxonte të hyj edhe në fushën e krijimtarisë, ku shkroi plot 12 romane, duke arritur edhe majat e vlerësimit nga qarqet akademike të asaj kohe.

Njohja e mirë e katër gjuhëve, e nxiti të shqipëronte mbi 25 libra të autorëve të huaj, të cilët u pëlqyen dhe vlerësuan maksimalisht nga lexuesit e që vazhdonjë akoma dhe sot të qarkullojnë nëpër librari.

Indiferentizmi ndaj politikës, shpërngulja nga Malësia në metropolin e zhurmshëm të Tiranës, rënia e interesit të lexuesit për librat, mungesa e komunikimit me malësorët, kolegët dhe miqtë e tij, si dhe diferencimi i kushtëzuar social, muajt e fundit të jetës tij, çoi në atë që quhet “shuarje e ngadaltë” e këtij personaliteti vizionar.

Megjithatë njerëzit e mëdhenj si Ramiz Lika, flasin me gjuhën veprave të tyre, si kurse foli gjatë gjithë kësaj “ore letrare” përkujtimore, me zërin e pjesëmarrësve, edhe pse me tonacion malli për mungesën e tij fizike.

Të shpërndarë në tavolina të baraslarguara 2-3 m larg njëra-tjetrës për të respektuar kushtet e reja të distancimit social, u dha mundësi pjesëmarrësve ta kthejnë këtë “orë letrare” në diskutim të lirë miqësor, ku secili solli kujtimet e tij me të ndjerin Ramiz Lika. Me seriozitetin dhe përkushtimin e gazetarit të TV Kopliku, njëkohësisht organizator, Gëzim Vuçaj, regjistroi të gjitha bisedat për transmetim më pas nga televizioni i Koplikut.

Ndër të pranishmit që sollën kujtimet e tyre ishin Kadri Ujka, Mimoza Rexhvelaj, Life Hasaj, Ndue Bacaj, Vlash Linadi, Bashkim Ramlekaj, Jonuz Delaj, Qazim Çela, Dakë Keqi etj., të cilët veç eksperiencave të tyre, vunë në dukje edhe disa shprehje shumë të veçanta të thëna nga i ndjeri Ramiz Lika, ku do të veçoja shprehjen që solli në vëmendje Isuf Heba...”letërsia është ndjenjë, ta pasqyrosh atë në letër, është vepër”.

Në këtë takim letrar nuk mungoi as përsëritja e Kryebashkiakut të Malësisë së Madhe z. Tonin Marina, i cili me atë sinqeritetin e malësorit dashamirës që e karakterizon në marrëdhënie me njerëzit, solli në vëmendje momentin emocional kur i dorëzoi titullin “Qytetar Nderi i Malësisë së Madhe” të dhënë nga Këshilli i Bashkisë së Malësi e Madhe, të cilin për arsye shëndetësore, tregoi se ia kishte dorëzuar në shtëpinë e tij.

Moment tjetër emocionues për z. Marinaj ishte edhe dorëzimi në emër të Shoqatës Kulturore “Sali Mani” të një Certificate “Mirënjohje” (pas vdekjes) gruas së tij të pranishme në këtë veprimtari, Nazire Lika. Në pamundësi pjesëmarrje në këtë takim letrar, u bashkuan në rrugë virtuale edhe miq e dashamirës të z. Lika, ndër të cilët do veçoja mikun dhe shokun e shkollës pedagogjike z. Ndoc Selimi, i cili solli në vëmendje një kujtim mjaft të vlefshëm për këtë shkrimtar të madh, që foli mbi romanin e tij të parë “Dallgët e Detit”, roman që u vlerësua aq shumë në atë kohë, sa mbajti pezull si në një bal-

ance vendimin e komisionit të çmimit për “Romanin e vitit” midis “Gjeneralit të Ushtrisë së Vdekur” të Kadaresë dhe romanit “Dallgët e detit” të Ramiz Likës, ku juria e kishte shumë zorshme të zgjedh. Në fund me pak diferencë fiton “Gjenerali...” i Kadaresë.

Në mbyllje përsëritet gruaja Nazirja dhe djali i tij Ervini, të cilët veç falënderimeve mirënjohjeje dhe krenarisë për njeriun e tyre të shtrenjtë, gjatë përsëritjes nuk u munguan as lotët e përmasimit.

Në shenjë respekti e për të ruajtur traditat e malësorit, familja dhe organizatorët shtruan një koktej për të pranishmit.

Me spostimin e të pranishmeve në krahun tjetër të lokalit, si ajo domethënia e shprehjes “hije që mbeten pas”, mbeti edhe tavolina e tejmbushur me vepra letrare me autorësi të shkrimtarit Ramiz Lika, si dhe romane të përkthyer nga vetë ai. Të baraspeshuara si mbi një balancë vlerash, këto libra shoqëroheshin me një mori mirënjohjesh, dekoratash dhe stimujsh moral të marra ndër vite, si edukator dhe shkrimtar, ku do veçoja urdhrin “Naim Frashëri”, diplomën “Mësues i Merituar”, titullin “Qytetar Nderi” e shumë të tjera, duke u dhënë zë veprave dhe meritave jetësore të mendimtarit të shquar malësorit Ramiz Lika, romancierit të parë në Malësi, i cili lindi dhe u shua në dy epoka tranzicioni kulturor, duke sfiduar me guxim edhe censurën e mendimit të lirë të sistemit të ndërmjetëm monist...

Mendimtarë si Ramiz Lika meritojnë të përjetësohen në emërimin e qendrave të edukimit dhe kulturës, e veçanërisht në tempujt e dijes, shkolla e biblioteka, për të cilat dha shumë.

Ramiz Lika jeton e do të jetojë me fjalën e shkruar ndër romane dhe vepra të shumta letrare.

"E SHTUNA LETRARO - ARTISTIKE" Mbledh SËRISH MENDIMTARËT MALËSOR NËN HIJEN E SHELQEVE PRANË BREGUT TË LIQENIT TË SHKODRËS

Ditën e shtunë, me 08 gusht 2020 në Malësi të Madhe u organizua një takim letrar-artistik, i cili pati një jehonë mjaft të madhe, çka u vu re në pjesëmarrjen e personaliteteve të pranishëm në këtë aktivitet.

Megjithëse i projektuar prej kohësh dhe i shtyrë për shkak të pandemisë, kjo veprimtari pati një rëndësi të veçantë jo vetëm për kohën që u realizua, por edhe për tematikat e larmishme që u diskutuan gjatë këtij takimi.

Në këtë veprimtari morën pjesë poetë, shkrimtarë, artistë, gazetarë e intelektual të shquar, ndër të cilët nuk munguan as të ftuarit nga qyteti i Shkodrës e më gjere. Të pranishëm ishin edhe instancat më të larta vendore, ndër ta edhe Kryetari i Bashkisë z. Tonin Marina.

Si kurrë më parë, në këtë takim kul-



Disa nga botimet e Ramiz Likës

tutor u prezantua libri "GJURMË HISTORIKE NË RRËNJËT KOMBËTARE" i autorit Gjon Frani Ivezaj pa prezencen e tij, çka i dha më shumë emocion diskutimit mbi këtë prurje, përmbajtja e të cilit ka një rëndësi të veçantë edhe për historiografinë shqiptare.

Prof. Gjon Fran Ivezaj me banim në SHBA është autor i disa librave historiko-kulturore.

I gjendur larg vendlindje së tij Malësisë së Madhe dhe i etur nga malli, patriotizmi, amaneti i traditave dhe dashuria për trojet e veta e nxisin të punojë pa u ndalur për të ndriçuar të vërtetat tona historike, aq shumë të politizuara nga akademia moderne bashkëkohore, çka vihet re edhe në librin e tij më të ri me shënime historike dhe kumtesa të cilat e identifikojnë mjaft qartë atë egon e tij si hulmues dhe studiues i përkushtuar.

Një studim me shumë vlerë do ta quaja këtë përmbledhje kumtesash dhe vëzhgimesh mbi të vërtetat historike me zanafilë që nga antikiteti e deri tek aktualiteti i trojeve etnike Ilire, pasi autori përdor një stil shpjegimi dialektik duke i dhënë edhe qartësi e kënaqësi lexuesit sado amator të jetë ai.

Studime të cilat autori i mbështet mbi dorëshkrimet e autoreve antik e deri tek ata të mesjetës së vonë, duke u dhënë kuptim kronologjik hipotezave që ngrenë në formë pikpyetjeesh, ku dhe u përgjigjet me pohime shkencorë, cungimit që historianët e politizuar vijojnë t'i vendosin historisë barriera pluhuri për interesa të ngushta vetjake.

Një tjetër aspekt kulturor që del në pah për lexuesin është organizimi i vazhdueshëm i shqiptarëve në mërgim për festa nacionale, tubime e organizime të ndryshme kulturore, deri edhe në mbledhjen vullnetare të të ardhurave për t'i investuar ato kudo në trojet shqiptare.

Gjatë prezantimit të këtij libri nuk



munguan diskutimet e miqve, kolegëve dhe intelektualëve pjesëmarrës, ndër ta Ndua Bacaj, Kadri Fikaj, Marash Çukaj, Prel Milani, Vlash Linadi, Fadil Hasmuja etj. të cilët e vlerësuan shumë pozitivisht këtë studim dhe përmbledhje kumtesash vetjake të autorit, nëpër veprimtari kulturore të organizuara nga mërgimtarët shqiptar në Amerikë.

Vëmendje të veçantë morën kumtesat që lidheshin me dy figurat e ndritura të kombit shqiptar, Gjergj Kastriotit dhe Nënë Terezës - Shenjtores së Kalkutës.

Me shumë emocion u mirëprit edhe fjala përshëndetëse e autorit e përcjellë në rrugë virtuale për të pranishmit dhe lexuar nga aktori më i ri malësor Bujar Hoxha, ku veç falënderimeve të përzemërta shpjegoi edhe arsyen e pamundësisë së pjesëmarrjes për shkak të pandemisë, në këtë takim mjaft të rëndësishëm për të.

Një tjetër tematike e rëndësishme e këtij takimi ishte shpallja e konkursit letrar "FJALA NË VARGUN POETIK TË MALËSORËVE" për çmimin "POETI GUXIMTAR" në nder të poetit të suksesshëm Gjek Marinaj, i cili sfidoi edhe çensurën e hipnozës së realizmit socialist me poezinë "KUAJT". Poezi të cilën e interpretoi për të pranishmit aktori i talen-

tuar Bujar Hoxha.

Ky konkurs u mirëprit mjaft mirë nga poetët malësor sa dhe u diskutua ta kthejnë atë në një veprimtari gjithëpërfshirës të përvitshëm.

Ky konkurs erdhi edhe si një indice nga konkursi poetik virtual i realizuar mjeshtërisht nga poetja e mirënjohur shkodrane znj. Frida Zmiani, pak kohë më parë, e cila ishte e ftuar speciale në këtë veprimtari, ku dhe i përgëzoi iniciatorët për këtë hap shumë të rëndësishëm për kohën. Nëpërmjet konkurseve tha ajo: ne do zbulojmë jo vetëm numrin e krijueseve, por edhe do nxisim poetët të rrisin cilësinë e tyre në krijimtari.

Një tjetër përshëndetje speciale për të pranishmit bëri edhe lahutari malësor, Rapsodi Jonuz Delaj me këngë folklorike, në të cilat spikasin fryma e patriotizmit dhe heroizmat e malësorëve të përjetësuar mbi tingujt e Lahutës, instrumentit të pavdekësisë bashkëshoqërueses së përhershme të malësorëve.

Me shumë pozitivitet u mirëprit edhe prezantimi i znj. Lida Haxhia, presidente e agjencisë turistike "LIDA-TREVEL", e cila veç diskutimit dhe vlerësimit mbi anën letraro-kulturore si poete, foli edhe për turizmin, rëndësinë dhe resurset

atraktive turistike, që ofron Malësia e Madhe, për turistët në këtë periudhë mjaft delikate në të cilën gjendemi.

Të gjitha këto tematika të përmbledhura në formë pyetësori nga organizatori Gëzim Vuçaj, gazetar dhe korrespondent i TV "Kopliku" dhe njëkohësisht drejtor i Revistës "Fjala" ia drejtoi numrit një në Malësi të Madhe, Kryetarit të Bashkisë z. Tonin Marinaj, i cili mbajti edhe fjalën përshëndetëse në emër të institucionit që drejton.

Me emocionet e rastit dhe rëndësinë e takimit, z. Marinaj përshëndeti organizatorët dhe të pranishmit, duke përgëzuar dhe vlerësuar punën e shkëlqyer të autorit Gjon Fran Ivezaj. Nota vlerësimi shprehu edhe për iniciativën e konkursit poetik, si dhe vëmendjen e agjencive turistike në Malësi të Madhe, ku vuri theksin mbi nevojat e reklamimit edhe të turizmit kulturor, për të cilin u shpreh se është në nivele jo të kënaqshme.


Me atë tonacionin e zërit ku dëshirën e mbyll pamundësia u ndal tek një problem shumë i diskutuar ndër vite. Ndërtimin e Qendrës Kulturore, ku si asnjëherë tjetër u shfaqësua me faktin se ende nuk kemi gjetur një hapësirë publike të përshtatshme për ndërtimin e një godine me parametra bashkëkohor, çka la të kuptohet se vetë malësorët duhet të ofrojnë mundësi bashkëpunimi për ta siguruar këtë hapësirë territoriale, diku në afërsi të qendrave të mëdha të banimit në Malësi.

Me diskutime të lira të shoqëruar me pije freskues e jo vetëm e duke shijuar ushqimet e servirura nga Bar-Restaurant "Rubens" në kokteil e shtruar enkas për të pranishmit u mbyll edhe kjo veprimtari mjaft i vlefshëm kulturor në Malësi të Madhe.

**Përgatiti Rita Shkurtaç,
Gusht 2020**

DY VJEÇ I BURGOSUR NGA FASHISTET

Në Shqipëri si në asnjë vend tjetër, kanë ndodhur çudira. Po ne gjithmonë kemi qëndruar të pa përkulur ndaj pushtuesve të gjitha ngjyrave, të cilët kaluan në këtë tokë të shqiponjave. Një nder krahinat më të sulmuara ka qene Dukagjini, jo vetëm nga Duçia e Hitleri, por edhe nga Zogu e Enveri. Nënshtrimi ndaj tyre për Dukagjinin ishte fjalë e 'huaj' Duke u përballuar me armë në këto troje. Ku fjala e dhënë është më rëndë se plumbi.



të cilët u mbajtën në burg deri sa negociuan me Mirashin për tu dorëzuar. Kur pranojë të dorëzohet u liruan nga burgu tre të arrestuarit, (në mesin e tyre) edhe Frani 2 vjeç. Përsëri Mirashi nuk u bindet pushtuesve, ndonëse u paraqit në xhandarmeri. Ju iku nga duart xhandarëve. Sado e forte të jetë era asnjëherë nuk

e ka fikur dritën e rrufesë. Sado të egra kanë qene erërat e shtetarëve, asnjëherë nuk mundën të ndalin Dukagjinin, për të luftuar kundër padrejtësive. Për luftën që Mirash Pali bëri në interes të Shqipërisë e në veçanti të Lotajve e Dukagjinit, pas 50 vitesh shpallet Dëshmor i Atdheut. Një vlerësim ky i merituar, ndonëse i vonuar!

Personazhi i shkrimit është Fran Mirashi i cili nuk e njohu asnjëherë t' atin, por u rrit me nënën, e cila ju bë babë, zot e zonje shtëpie. Bute Gjergjia e rriti djalin e vetëm e edukoi, me ndjenjat e tiparet më të mira, të trashëguara nga dy familjet e njohura si në Lotaj ku lindi dhe te dajave në Theth, bijë nga ishte Butja.

Frani, që në fëmijëri dallohej për

zguarsi. Këtë e tregonin notat në shkollë, të cilat ishin të shkëlqyera. Për vet kushtet në familje ju desh të piqej para kohe. Të bëhej zot shtëpia. Në moshë fare të re ai marthohet me Dilë Vaten nga një familje e nderuar e respektuar, nga fshati Lekaj. Çifti linden e rriten 6 fëmijë, me një edukate për tu admiruar. Të gjithë kanë mbaruar shkolla e punojnë. Tre prej të tyre punojnë e jetojnë në Itali. Të tjerët jetojnë në vend. Për të gjithë Frani është kryelarte se punojnë e jetojnë me ndershmëri. Fjalët më të mira flasin ata me te cilët punojnë e jetojnë në bashkësi.

Frani kurdoherë ka qene i angazhuar në detyra të rëndësishme në pushtet e në ekonomi. Për disa legjislatura është zgjedhur kryetar i këshillit të fshatit. Po edhe në ekonomi ai ka punuar në organet drejtuese ekonomike në fshat e zonë, përgjegjës sektori, ekonomist, etj. Detyra këto të kryera me ndershmëri. Ka marrë me dhjetëra stimuj moral të kohës. Asnjë herë nuk e harrojë babën e vet! Me dhjetëra letra e kërkesa ju dërgoi, strukturave qeveritare të kohës, prej të cilave mori përgjigje negative. Kuptohet se vendi ishte i izoluar, aq sa jashtë kufijve nuk mundë të interesohej. Në Shqipëri kërkoi në disa qytete e fshatra ku mundë të mësoj diçka, duke filluar nga Gashi në malësinë

e Gjakovës, Durrës, Tiranë, Elbasan e Vlorë etj, se ku mund të jetë varrosë Mirash Pali. Një shtysë e madhe u bë nga djemtë, të cilët, falë hapjes të Shqipërisë. Nuk lanë vend të Evropës pa kërkuar, deri sa mësuat të vërteten. Mirashi kishte vdekur në kampet e përqendrimit në Gjermanin Perëndimorë. Pavlini djali i dytë i Franit, nuk reshti s' kërkuari (asnjëherë) deri sa mësoje të vërteten. Ata që e kanë njohur Mirashin, thoshin se: Pavlini ishte kopje e gjyshit, nga paraqitja, po edhe në tiparet e tij. Besa, bujaria, ndershmëria, por edhe trimëria, e kanë shoqëruar gjatë punës në Policinë e Shtetit, gjithnjë në zbatim të ligjeve, dhe komunikimin e ngrohtë me njerëzit.

Frani, ndonëse po i mbushë të 80 të duket si një 50 vjeçar. Nuk ka gëzime apo hidhërime nga banorët e Lotajve e më gjere, të mos drejtohet nga Frani. Kjo vërteton, se duke ndjekur traditat e mira të parëve i ka trashëguar dhe këto trashëgime janë dhurata më e mirë, që Frani ju ka kultivuar djemve, vajzës, nipave e mbesave të tij.

Po mbylli këtë shkrim me urimin: Të paçim edhe shumë e shumë vite në mesin tone, ashtu siç je sot, mendje kthjellte, humane e gazmorë !!!

Përgatiti NDUE ZIÇI



REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**
 Redaktorë: Suela Ndoja, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani,
 Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku,
 Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj,
 Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e
 Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:
GJERGJ GURI,
BRUKSEL

